

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7750 E mërkurë 26 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion i Ditës

Shumë qytetarë sot me të drejtë pyesin, duke parë titujt sensationale "euro në pikiatë në Shqipëri!": "more, ç'po ndodh vërtet me euron?". Shumë media ...  
Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI

## Euro nga ballkoni i katit të parë



## Dje në "Deutsche Welle"

Bashkimit European iu desh të bmenaxhonte shumë kriza më 2018-ën, që nga bisedimet e zvarritura për Brexitin, grindjet për tregtimin me SHBA, rritjen ...  
Vijon në faqen 21

Nga BERND RIEGERT

## 2019, më shumë të djathtë në Parlamentin European



KQZ do nisë me zarf fletën e votimit

## Propozimi i PS, emigrantët do të votojnë me postë ose elektronikisht

Amendamentet e socialistëve/ Çdo emigrant duhet të bëjë kërkesë paraprake për të votuar pranë Komisionit të Zgjedhjeve

Të gjithë emigrantët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit do kenë mundësi që të shprehin vullnetin e tyre për forcat politike dhe kandidatët që duhet të drejtojnë vendim dhe qytetin e tyre. Partia Socialiste ka zyrtarizuar në Kuvend ndryshimet në Kodin Zgjedhor, ku ndërmyjet të tjerave plotëson edhe një kërkesë të hershme ...  
Në faqen 3

## TABELAT E PLOTA/ SI NDRYSHON FORMULA E PERLLOGARITJES PER BURRAT DHE GRATE

# PENSIONET NE 2019, MOSHA DHE VJETERSIA NE PUNE

Reforma e miratuar në vitin 2014, gratë dalin në pension në moshën 60 vjeçe e 10 muaj, ndërsa burrat 65 vjeç. Nevojiten 35 vite e 8 muaj për pension të plotë

PER BURRAT						PER GRATE					
Vitet	Kategoria I	Kategoria II	Kategoria III	Vitet	Kategoria I	Kategoria II	Kategoria III				
	Muaj	Vjetërsia e punës	Muaj	Vjetërsia e punës	Muaj	Vjetërsia e punës	Muaj	Vjetërsia e punës			
01.07.2010	30	35	40v 6m	35	40v 6m	35	35				
01.07.2011	30	32	44v	35	40v	35	35				
01.06.2012	30	32	44v	35	40v	35	35				
01.07.2013	30	33	44v 6m	35	40v	35	35				
01.06.2014	40	34	45v	35	40v	35	35				
01.07.2015	40v 6m	35	45v	35v 6m	35	40v	35v 6m				
01.12.2016	40v 6m	35v 6m	45v	35v 6m	35v 6m	40v 6m	35v 6m				
01.12.2018	40v 6m	35v 6m	45v	35v 6m	35v 6m	40v 6m	35v 6m				

(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore



## PROCEDURAT

**Punësimi në administratë, qeveria ndryshon rregullat e pranimit**  
Në faqen 4

## ARTISTI

**Matis, ballë telajos gjer në ditën e fundit të jetës**  
Në faqen 18-19

## VIP PAGES

**Aromë festash, Katerina Zoto: Ja çfarë është 'in' këtë sezon**

## KREU I FEDERATES

**Duka: Panuçit i kam bërë vërejtje, Partizani është me meritë në krye**  
Në faqen 22

## 80% HODHEN LOTARINE



**Sindikata e policisë, i dërgon letër Ramës: Pagë e 13 dhe orët shtesë**  
Në faqen 7

Vrasja në Bllok/ Prokuroria heton mesazhin e mbërritur në telefonin e viktimës

## SMS në telefonin e Gaxhës: Eja me armë

Mjekët: Jeta e të plagosurit Elion Hato në rrezik, duhet të kurohet

Afro tre muaj pas masakrës me një të vrarë dhe dy të plagosur në lokalin "Monopol" në zonën e ish-Blokut, ekspertët e Mjekësisë Ligjore kanë arritur në përfundimin se qëndrimi në qelitë e paraburgimit vë në rrezik jetën e Elion Hatos. Sipas ekspertëve, 28-vjeçari,



i cili u plagos mbrëmjen e 4 tetorit të këtij viti duhet të mbahet në ambientet e një spitali civil, ku mund të marrë shërbim të specializuar. Mësohet se i paraburgosuri i është drejtuar gjykatës së Tiranës me kërkesën për ndryshimin e masës së sigurisë, pasi ...  
Në faqen 6

## ZGJEDHJET FORUMET

Valentina Madani

Partia Demokratike rifilloi procesin e zgjedhjeve të brendshme në muajin janar për të zgjedhur kryesinë e re, nënkryetarët dhe sekretariatit e ri të partisë. Përzgjedhja e ekipit të ri politik të Lulzim Bashës shihet si tejet e rëndësishme, pasi do të influencojë të gjitha hapat e mëtejshme të partisë më të madhe të opozitës, e cila synon fitoren e zgjedhjeve të ardhshme. PD më 15 dhjetor mbledhi Kuvendin Kombëtar. Nga kjo mbledhje doli Këshilli i ri Kombëtar, i cili do të zgjedhë drejtuesit e rinj të partisë, me të cilët Lulzim Basha do synojë fitoren e zgjedhjeve të ardhshme lokale. Kreu demokrat Lulzim Basha ka vendosur që Këshillin e ri Kombëtar ta thërrasë sërisht në muajin janar për të hapur garën për postet drejtuese në PD. Ethet e garës tashmë po ndihen në selinë e PD-së, ndërsa mbetet për t'u parë kush do të jetë ekipi i ri i Lulzim Bashës për betejën e zgjedhjeve lokale të qershorit dhe betejat e tjera elektorale. Anëtarësia e këtij forumi do të votojë njëherë nga dy kandidatit që do të paraqiten për çdo post drejtues. Burime brenda PD-së bëjnë me dije se në garë do të rifuten drejtuesit aktualë, si nënkryetarët Edi Paloka dhe Edmond Spaho, sekretari i përgjithshëm Arben Ristani, sekretari organizativ Enno Bozdo, sekretari i burimeve njerëzore Patbardh Kadilli etj. Ndërkohë që për në kryesi do të garojnë edhe krerët aktualë të departamenteve. Kandidatët që do të rifuten në garë ditët e para të janarit pritet të nisnin lobimet ndërkohë që surprizën në garë do të jenë edhe emrat e disa prej deputetëve aktivë në parlament si dhe në protesta. Por, demokratët do të kenë edhe një tjetër moment zgjedhës brenda tyre. Pas mbledhjes së Këshillit Kombëtar, do të jetë një tjetër mbledhje e kryesisë së partisë, e cila do të vendosë për krerët e departamenteve në PD. Pranë PD-së funksionojnë departamentet si strukturë këshillimore e kryesisë dhe kryetarit të PDSH-së. Numri i departamenteve dhe fusha e veprimtarisë që mbulojnë përcaktohen me vendim të kryesisë së partisë dhe drejtuesit e departamenteve zgjidhen me propozim të kryetarit nga kryesia e PDSH-së.

### GARA

Mbledhja e 15 dhjetorit e Kuvendit Kombëtar të PD-së u ka hapur rrugë zgjedhjeve në të gjithë strukturën bazë dhe përcakton ekipin me të cilin Lulzim Basha synon fitoren e zgjedhjeve lokale dhe

PD sërisht zgjedhje, nënkryetarët dhe sekretariatit pa mandat që nga muaji nëntor

# Zgjedhjet në PD, në janar gara për kryesinë dhe sekretariatit


## Futen në garë edhe deputetët më aktivë



Kreu i PD-së Lulzim Basha

### Vasili: Kriza e qeverisjes është pa kthim

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili shprehet se qeverisja aktuale po shkatërron ekonominë e vendit. Vasili shprehet në "Facebook" se kriza në qeverisje është diçka pa kthim, pa prioritete, pa asnjë ideologji, duke zhbërë në këtë mënyrë edhe premtimet e bëra gjatë fushatës elektorale. Ai shkruan me ironi se, avokatia e kufomave është njëlljoi e vdekur si vetë qeveria. "Avokatia e disave për këtë qeverisje është e njëjtë me atë të shpresës se një kufome që ka dhënë shpirt do të ngjallet sërisht. Akoma me vulgare është avokatia e me demokundryshimeve mbarëpopullore që kryeministri më antipopullor po dashka që të bëjë. Këto ndryshime në qeveri janë njëlljoi si t'i ndryshosh kufomën kostumin, duke harruar që ajo sërisht kufomë mbetet. Avokatia e kufomave është njëlljoi e vdekur si ato. Avokatia e agonisë së një qeverisjeje të marrë fund është shërbimi më i keq që mund t'i bëhej asaj, sepse e bën edhe atë qesharake sa më s'behët, edhe avokatit e saj kufoma njëlljoi si ajo", shprehet z.Vasili.



Kuvendi Kombëtar i PD-së

### PD, gati për pushtet? Duma: Nuk duhet të ketë delir

Deputetja e PD-së, Grida Duma, e ftuar dje në "News 24" denoncoi qeverisjen e majtë, që sipas saj rrethoi jetesën e shqiptarëve për pasurimin e një grupi pushtetarëve. "Ne vumë prioritetin si opozitë heqjen e kriminit nga politika. Ne me mënyrën se si e kemi parë, e kemi kuptuar se problemi nis nga kjo. Mazhoranca duhet të mbajë përgjegjësi. Atë që shoh jashtë PD është një ngërç. PD duhet të ekzistojë për shoqërinë dhe jo për vetveten. Kjo është filozofia", tha Duma. Teksa u pyet në lidhje me faktin nëse PD është gati të marrë qeverinë, Duma tha se opozita nuk duhet të ketë delir duke menduar se mund të jetë gati. "Do vlerësoja shumë që në marrjen e përgjegjëseve, PD mos të ketë delirin që është gati. Këto janë të ekuacionit duhet të evitohen. Në rastin e Ramës, ne kemi problem dhe tashmë, pasi sipas meje, ai është lideri i gjithanshëm. Ai beson se ka të drejtë që t'i bëjë të gjitha vetë. Nuk ka ministër në qeverinë "Rama" dhe kjo është gënjehur. Gjeja më e humbur në Shqipëri është kontrata elektorale", - tha Duma.

### STATUTI I PD-SË

#### Neni 50

Kompetencat e Këshillit Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar drejtohet nga kryetari i keshillit, i cili zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit Kombëtar, në mbledhjen e tij të parë të konstitimit, për një mandat 4-vjeçar.
2. Mbledhjen e Këshillit Kombëtar e thërret kryetari i partisë, ose kryetari i keshillit me miratim të kryetarit të partisë, pas konsultimit me kryesinë e partisë. Këshilli Kombëtar mund të mbledhet edhe nëse e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të tij. Në këtë rast, kryetari thërret mbledhjen jo më vonë se dy javë nga data e depozitimit të kërkesës. Këshilli Kombëtar, si rregull, mbledhet jo më pak se një herë në vit. Data e mbledhjes dhe rendi i ditës duhet t'u njoftohen anëtarëve jo më vonë se 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes.
3. Këshilli Kombëtar merr të gjitha vendimet e rëndësishme politike që mund të kërkojnë rrethan kur Kuvendi Kombëtar nuk është i mbledhur dhe kur ato nuk janë parashikuar në këtë statut si e drejtë vetem e Kuvendit.
4. Këshilli Kombëtar, me propozim të kryesisë së PDSH-së ose kryetarit të partisë, zgjedh dhe/ose shkarkon, me votim të fshehtë:
  - a) Kryetarin e Këshillit Kombëtar.
  - b) Sekretarin e përgjithshëm.
  - c) Nënkrerëtarët e partisë.
  - d) Anëtarët e zgjedhur të kryesisë së PDSH-së.
  - e) Sekretarët funksionale.

- f) Komisionin e Apelitit;
- g) Kryetarin e Bordit Financiar të Partisë.

5. Këshilli Kombëtar, me propozim të kryesisë së PDSH-së ose kryetarit të partisë, ushtron edhe këto përgjegjësi apo të drejta:
  - a. Miraton rregulloren e brendshme dhe aktet e tjera të nevojshme nënstatutore për zbatimin e këtij statuti apo mbarëvajtjen e punës në parti.
  - b. Miraton listën e kandidatëve elektorale sipas vendimit të kryesisë së PDSH-së.
  - c. Shpall masat disiplinore për anëtarët e Këshillit Kombëtar apo kryesisë së PDSH-së, të cilat mund të ankimojnë pranë Komisionit të Apelitit.
  - d. Miraton koalicionet para apo pas zgjedhore.
  - e. Miraton strategjitë dhe programin elektorale dhe politik të PDSH-së.
  - f. Miraton anëtarët e emëruar nga kryesia e PDSH-së në Komisionin e Vlerësimit të Kandidaturave, Komisionin e Integritetit dhe Etikës, si dhe Komisionin Zgjedhor.
  6. Jo më pak se 15 për qind e anëtarëve të Këshillit Kombëtar kanë të drejtën që jo më vonë se 24 orë përpara mbledhjes së tij, të propozojnë kandidatë alternativ për çdo funksion politik që zgjidhet nga ky organ sipas pikës 4 të këtij neni.

rikthimin e së djathtës në pushtet. Zgjedhjet e reja në PD përfshijnë të gjitha nivelet, përjashtuar atë të kryetarit Lulzim Basha, i cili është rizgjedhur me afro 90 për qind të votave në këtë post. Nënkrerëtarët dhe sekretariatit janë pa mandat që nga muaji nëntor. Nga mbledhja e 15 dhjetorit, Kuvendi Kombëtar votoi keshillin e kombëtar, i cili do të zgjedhë kryesinë e PD-së, dy nënkryetarët e partisë, sekretarin e

përgjithshëm dhe sekretariatit. Gjatë procesit të zgjedhjeve brenda PD-së u aplikua parimi "një anëtar, një votë" që nga grupseksioni, deri tek kalimi i vendimeve në organet kolegjiale dhe pritet të forcojë partinë dhe demokratizojë vendimarrjen. Janë kryesitë e degëve, ato të cilat duhet të japin mendimin e tyre për kandidataturat për keshilltar bashkiak dhe më pas të merret mendimi për kandidataturat për kryetar të push-

tetit lokal, zgjedhjet për të cilët janë vetëm 7 muaj larg. Që prej Kuvendit Kombëtar të 28 prillit, urdhret e kryetarit të PD-së u kthyen në normë statutore. I fillë është edhe ai i 11 majit, i cili detyronte mbylljen deri më 30 qershor të zgjedhjeve në grupseksionet dhe seksionet e partisë, sipas parimit "një anëtar, një votë". Por nuk u zbatua urdhri që motivohej me zgjedhjet vendore pranë, e nevojën e qytetarëve për një ofertë për prob-

lemet socio-ekonomike, përballë një mazhorance që demokratët e akuzojnë të kriminalizuar dhe të korruptuar. Për shkak të axhendës politike të opozitës, e cila i ka nisur betejën për shkëputjen e politikës nga krimi, zgjedhjet e brendshme u shtynë sërisht, ndërkohë që më 15 dhjetor u përcaktua ekipi i ri i Lulzim Bashës me të cilin demokratët do të shkojnë drejt fitores së zgjedhjeve lokale dhe atyre të përgjithshme.

REDAKSIONI: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delsula, Dossier: Iv Kaloci, Redaktor i Rrethëve: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli.

Art Designer: Nevila SAMARXHI. ADMINISTRATA: Përgjegjësi e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel 0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtorja e Uzinës së Autoraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel/Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik" Shpk





Socialistët propozojnë votimin elektronik të shqiptarëve që jetojnë jashtë

# Propozimi, emigrantët do të votojnë me postë ose elektronikisht

*KQZ do t'u nisë atyre fletën dhe procedurën e votimit me zarf*

**T**ë gjithë emigrantët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit do kenë mundësi që të shprehin vullnetin e tyre për forcat politike dhe kandidatët që duhet të drejtojnë vendin dhe qytetin e tyre. Partia Socialiste ka zyrtarizuar në Kuvend ndryshimet në Kodin Zgjedhor, ku ndërmyjet të tjerave plotëson edhe një kërkesë të hershme të shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë, pra të drejtën për të votuar atje ku banojnë. Votimi parashikohet të bëhet me zarf nëpërmjet postës, ose nëpërmjet sistemit elektronik, ndërsa votat për efekt përllogaritje do t'i njihen zonës zgjedhore, Qarku Tiranë.

**PROCEDURA**

Zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të votojnë në zgjedhjet për Kuvendin nga vendi ku jetojnë, nëse kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit. Pra, që një shtetas që jeton jashtë vendit që të mund të votojë duhet më parë të qartësojë në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e tij zyrtare të vendit ku jeton, por para një afat të caktuar, para datës së mbajtjes së zgjedhjeve. Gjithashtu, përveç kësaj, ai duhet të shprehë dëshirën dhe të kërkojë nga KQZ-ja që të votojë dhe të pajset me dokumentacionin e votimit nga jashtë. Kërkesa për votim nga jashtë t'i bëhet e ditur KQZ-së nëpërmjet instrumenteve të kontaktit të KQZ-së dhe ajo është individuale dhe nuk përfaqëson vullnetin e votuesve të tjerë familjarë të kërkuarit, bashkëjetues ose jo me të. KQZ-ja pasi verifikon identitetin e kërkuarit, shtetësinë dhe vendbanimin të përhershëm jashtë vendit, që figuron në Regjistrin Kombëtar Elektronik të Gjendjes Civile.



**KËRKESA**

Kërkesa për votim nga jashtë do t'i bëhet e ditur KQZ-së nëpërmjet instrumenteve të kontaktit të KQZ-së dhe ajo është individuale e nuk përfaqëson vullnetin e votuesve të tjerë familjarë të kërkuarit, bashkëjetues ose jo me të.

**NDRYSHIMET E PROPOZUARA NGA PS NË KODIN ZGJEDHOR**

**Votimi nga jashtë vendit**

- Zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të votojnë në zgjedhjet për Kuvendin, nga vendi ku jetojnë nëse:
  - kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit; dhe
  - kërkojnë nga KQZ-ja që të pajset me dokumentacionin e votimit nga jashtë. Formati dhe mënyra e paraqitjes së kërkesës përcaktohet me vendim të KQZ-së.
- Zgjedhësit mund të votojnë nga vendi ku jetojnë në rast se kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit, jo më vonë se ditë para datës së zgjedhjeve.
- Zgjedhësit mund të votojnë nga vendi ku jetojnë në rast se kërkesa për votim nga jashtë t'i bëhet e ditur KQZ-së nëpërmjet instrumenteve të kontaktit të KQZ-së, jo më vonë se ditë para datës së zgjedhjeve. Kërkesa është individuale dhe nuk përfaqëson vullnetin e votuesve të tjerë familjarë të kërkuarit, bashkëjetues ose jo me të. KQZ-ja, pasi verifikon identitetin e kërkuarit, shtetësinë dhe vendbanimin të përhershëm jashtë vendit, sipas Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, qartëson zgjedhësin për votim. Zgjedhësi qartësohet për votim, vetëm nëse:
  - Zgjedhësi referon si adresë kontakti, adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit, që figuron në Regjistrin Kombëtar Elektronik të Gjendjes Civile.
  - Të dhënat identifikuese që deklarohen përputhen me të dhënat sipas regjistrit dhe regjistri nuk përmban shënime, sipas të cilave zgjedhësi ka nuk ka më shtetësinë shqiptare.

- Pas qartësimit për votim, KQZ-ja i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile që të përfshijë në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit të dhënat për zgjedhësit që kanë kërkuar të votojnë nga jashtë vendit.
- Pas shpalljes së listës përfundimtare të zgjedhësve dhe miratimit të fletës së votimit, KQZ-ja njofton dhe sipas rastit, pajset me dokumentacionin zgjedhor votuesit nga jashtë vendit.
- Në rast se votimi nga jashtë vendit kryhet si votim manualisht, atëherë KQZ-ja i dërgon zgjedhësit nëpërmjet Postës Shqiptare, me shërbimin e shpejtë me garanci dorëzimi që ofron shërbimi postar, dokumentacionin e votimit (zarfet dhe fletën e votimit) në fuqi për këtë lloj votimi, udhëzimet për postimin e fletës së votimit të plotësuar dhe afatin e vlefshëm për mbërritjen e fletës së votimit në KQZ dhe përfshirjen e saj në votim. Rregulla më të detajuara teknike dhe procedurale për zbatimin e këtij neni përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.
- Në rast se votimi nga jashtë vendit kryhet si votim elektronik, atëherë KQZ-ja i dërgon zgjedhësit nëpërmjet Postës Shqiptare, me shërbimin e shpejtë me garanci dorëzimi që ofron shërbimi postar, dokumentacionin udhëzues për procedurën e votimit me, sipas rastit, kodet e sigurisë që parashikon procedura e votimit në fuqi për këtë lloj votimi, udhëzimet për afatin për kryerjen e votimit elektronik dhe shpjegimet për procedurën e përfshirjes së votës elektronike në rezultat.

## Procedura, ja si do të numërohen votat e emigrantëve

**N**ë ndryshimet ligjore të paraqitura nga socialistët parashikohet një procedurë e detajuar edhe e mënyrës se si do të realizohet numërimi i votës së emigrantëve. Kështu, numërimi manual i votave nga jashtë vendit kryhet menjëherë pas mbylljes së votimit nga jashtë vendit dhe për këtë KQZ-ja organizon numërimin e votave në VNV-në e caktuar dhe të njoftuar paraprakisht për këtë qëllim. Numërimi i votave bëhet nga personeli i KQZ-së, me jo më pak se dhjetë GNV, me nga dy anëtarë secili. Numërimi i votave bëhet me pjesëmarrjen dhe vëzhgimin e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve zgjedhore dhe të vëzhguesve. Protokollin e KQZ-së u dorëzon GNV-ve zarfet e mbërritura në KQZ, të protokolluara dhe të paketuara sipas shteteve të origjinës, me jo më shumë se një mijë zarfet për paketë. Përpara numërimit GNV-të qartësojnë votuesit nëpërmjet leximit të bar-kodit që ndodhet në zarfin kuverto dhe verifikimit të përputhshmërisë me të dhënat në listën e qartësimit të procedurës së votimit. Pas shpalljes së listës përfundimtare të zgjedhësve dhe miratimit të fletës së votimit, KQZ-ja njofton dhe sipas

**VOTAT ELEKTRONIKE DO NUMËROHEN NGA SISTEMI I TI-SË**

Numërimi i votave të emigrantëve të hedhura nëpërmjet votimit elektronik bëhet nga sistemi i teknologjisë së informacionit. Rezultati me numrin e përgjithshëm të votuesve nga jashtë vendit dhe vlerësimin e votave del si e dhënë nga informacioni që është regjistruar dhe ruajtur në bazën e të dhënave të votimit elektronik, nga momenti i çeljes së votimit nga jashtë vendit deri në momentin e mbylljes së tij.

rastit pajset me dokumentacionin zgjedhor votuesit nga jashtë vendit. Në rast se votimi nga jashtë vendit kryhet si votim manualisht, atëherë KQZ-ja i dërgon zgjedhësit nëpërmjet Postës Shqiptare, me shërbimin e shpejtë me garanci dorëzimi që ofron shërbimi postar, dokumentacionin e votimit (zarfet dhe fletën e votimit) me udhëzimet për procedurën e votimit në fuqi për këtë lloj votimi, udhëzimet për postimin e fletës së votimit të plotësuar dhe afatin e vlefshëm për mbërritjen e fletës së votimit në KQZ dhe përfshirjen e saj në

votim. Në rast se votimi nga jashtë vendit kryhet si votim elektronik, atëherë KQZ-ja i dërgon zgjedhësit nëpërmjet Postës Shqiptare, me shërbimin e shpejtë me garanci dorëzimi që ofron shërbimi postar, dokumentacionin udhëzues për procedurën e këtij lloji votimi.

**VOTIMI**  
Votimi nga jashtë vendit quhet i çelur nga dita që KQZ-ja nis procedurat për dërgimin e dokumentacionit të votimit. Pavarësisht nga procedura e votimit, manuale ose elektronike, votat e votuesve nga jashtë

vendit administrohen nga KQZ-ja, duke garantuar integritetin e votimit dhe fshtetësinë e votës nga çdo ndërhyrje mbi fletën e votimit ose mbi informacionin elektronik të votimit që administrohet prej saj. Votimi nga jashtë vendit mbyllet në ditën e votimit dhe në orën e caktuar për mbylljen e votimit në qendrat e votimit. Me mbylljen e votimit nga jashtë vendit, KQZ-ja nuk mund të pranojë dhe nuk përfshin më në numërim asnjë fletë votimi të mbërritur më pas. E njëjta procedurë dhe afate ndiqet edhe për votimin elektronik.

## Meta: Urtësi për të çelur negociatat me BE

### Politika uron Krishtlindjet, thirrje për më shumë bashkëpunim

Politikanët zgjidhën dhe festën e Krishtlindjes që t'i bëjnë apel mazhorancës dhe opozitës për më shumë bashkëpunim për të mirën e vendit. Presidenti Ilir Meta zgjodhi që këtë Krishtlindje krahas urimit për shqiptarët të adresojë një mesazh të veçantë për klasën politike, e cila në këtë ditë feste zgjodhi të pushojë, duke qenë e kursyer edhe me vizitat në institucionet fetare. Teksa ftoi palët të bashkëpunojnë duke pasur si udhërrëfyes modelin e bashkëjetesës fetare në vend, kreu i shtetit uroi që Krishtlindjet e ardhshme të ndezin dritën jeshile për Shqipërinë në

rrugën drejt unionit. "Është një ditë që na fton të gjithëve të shtojmë urtësinë dhe mençurinë që Krishtlindjet e tjera të na gjejnë jo vetëm më të gëzuar dhe më të bashkuar, por edhe të na gjejnë me negociata të çelura për anëtarësimin në BE", tha z.Meta. Kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi veçoi në këtë urim të gjithë emigrantët që kanë ardhur pranë të dashurve të tyre për të kaluar festën. Ai shkruan mes tjerash se lumturia e di gjithëve, jo pasuria e disave, e bënë jetën më të mirë dhe më të ngrohtë. Kryeministri Rama zgjodhi që mesazhin e tij të urimit ta

japë përmes një videoje në rrjetet sociale me një dedikim kushtuar vogëlushëve të Shtëpisë së Fëmijës. Kreu i opozitës, Lulzim Basha urimin drejtuar besimtarëve të krishterë në këtë ditë feste e solli përmes një kartoline. Ndërsa Kryebashkiaku Erjon Veliaj krahas mesazhit për shqiptarët paralajmëroi se 2019 do të jetë një vit pune për kryeqytetin. Monika Kryemadhi i kujtoi klasës politike përgjegjësitë që kanë për popullin shqiptar Kurse Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, një urim special bëri për të gjithë ushtarakët shqiptarë dhe për familjet e tyre.

#### 'DHURATA'

Disa studentët protestues i bënë dhe një dhuratë kryeministrit Rama me rastin e Krishtlindjes. Dhuratë një palë pantallona dhe një mesazh. "Të bëhet serioz dhe të lexojë Kushtetutën" - tha një student.



Procedurat, kandidatit i duhen 45 pikë për të kaluar në testimin me gojë

# Punësimi në administratë, qeveria ndryshon rregullat e pranimit

## Duhen 30 pikë nga testimi me shkrim

Qeveria ka ndryshuar rregullat e rekrutimit dhe konkurrit në administratën shtetërore. Tashmë asnjë kandidat që konkurren për një vend pune në administratën publike nuk do mund të kalojë në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit nëse nuk grumbullon një sasi të caktuar pikësh nga vlerësimi me shkrim dhe po ashtu nuk mund të kalojë as në fazën e konkurrit me gojë nëse nuk ka marrë një sasi minimale pikësh për dy fazat e mëparshme. Qeveria miratoi javën e shkuar disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe pranimin", ku ndërmytet të tjerave ka parashikuar që asnjë kandidat që ka aplikuar për një vend pune në administratën publike të mos kalojë në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit nëse nuk ka grumbulluar të paktën 30 pikë nga vlerësimi me shkrim. "Nëse kandidati grumbullon më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë) nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të jetëshkrimit", -thuhet në vendimin e miratuar. Jo vetëm kaq, por nëse kandidati nuk arrin që në dy fazat e para të marrë së bashku 45 pikë atëherë ai nuk mund të kalojë në fazën e testimit me gojë. "Nëse kandidati grumbullon mbi 45 (dyzet e pesë) pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë", përcaktohet më tej në këtë vendim. Ky rregull vlen si për kandidatët për nivelet e ulëta dhe ato të larta në administratën publike. Gjithashtu, ky vendim bën edhe disa përcaktime të reja për fazën pas konkursit dhe shpalljes së rezultateve. Kështu sipas



#### FITUESIT

Kandidatët që nuk paraqiten për të zgjedhur pozicionin e punës, sipas ftesës së bërë nga njësia përgjegjëse, për shkak të arsyeshme, njoftojnë njësinë përgjegjëse për pamundësinë e pjesëmarrjes së tyre të paktën deri në orarin e përcaktuar prej saj për paraqitjen e kandidatëve.

këtyre rregullave të reja që vendosin këto ndryshime kandidatët që nuk paraqiten për të zgjedhur pozicionin e punës, sipas ftesës së bërë nga njësia përgjegjëse, pa shkak të arsyeshme, humbasin të drejtën e zgjedhjes nga lista e pozicioneve për të cilën janë ftuar të zgjedhin dhe të drejtën e qëndrimit në listën fituese. Ndërsa kandidatët që nuk paraqiten për të zgjedhur pozicionin e punës, sipas ftesës së bërë

nga njësia përgjegjëse, për shkak të arsyeshme, njoftojnë njësinë përgjegjëse për pamundësinë e pjesëmarrjes së tyre të paktën deri në orarin e përcaktuar prej saj për paraqitjen e kandidatëve. Në këtë rast njësia përgjegjëse shtyn datën e paraqitjes së kandidatëve fitues në një datë tjetër. Sipas këtij vendimi, shkaqe të arsyeshme konsiderohen rastet e sëmundjeve të kandidatit fitues, fëmijëve të

mitur apo bashkëshortit/ës, vërtetuar me dokument mjekësor, si vdekja e prindërve, bashkëshortit/ës, fëmijës, vëllezërve apo motrave. Pas marrjes së aktit të emërimit, kandidati fitues detyrohet të paraqitet pranë institucionit ku është emëruar, jo më vonë se 5 ditë pune nga data e marrjes së aktit. Në rast të mosparaqitjes së kandidatit fitues, brenda afatit të përcaktuar, institucioni ku kandidati është emëruar, njofton njësinë përgjegjëse brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i afatit. Në këtë rast njësia përgjegjëse vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ (akti i emërimit), në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

#### VENDIMI

- Shpallja është e hapur për të gjithë kandidatët nga jashtë shtetit civil. Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për konkurrim. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes në:
  - faqen zyrtare të DAP-it dhe portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", për institucionet e administratës shtetërore;
  - portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të internetit dhe në ambientet e brendshme, për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.
- Nëse kandidati grumbullon më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë) nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të jetëshkrimit. Nëse kandidati grumbullon mbi 45 (dyzet e pesë) pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë.
- Kandidatët që nuk paraqiten për të zgjedhur pozicionin e punës, sipas ftesës së bërë nga njësia përgjegjëse, pa shkak të arsyeshme, humbasin të drejtën e zgjedhjes nga lista e pozicioneve për të cilën janë ftuar të zgjedhin dhe të drejtën e qëndrimit në listën fituese. Kandidatët që nuk paraqiten për të zgjedhur pozicionin e punës, sipas ftesës së bërë nga njësia përgjegjëse, për shkak të arsyeshme, njoftojnë njësinë përgjegjëse për pamundësinë e pjesëmarrjes së tyre të paktën deri në orarin e përcaktuar prej saj për paraqitjen e kandidatëve. Në këtë rast njësia përgjegjëse shtyn datën e paraqitjes së kandidatëve fitues në një datë tjetër. Shkaqe të arsyeshme konsiderohen:
  - Rastet e sëmundjeve të kandidatit fitues, fëmijëve të mitur apo bashkëshortit/ës, vërtetuar me dokument mjekësor;
  - Vdekja e prindërve, bashkëshortit/ës, fëmijës, vëllezërve, motrave;
  - Forcat madhore.
- Pas marrjes së aktit të emërimit, kandidati fitues detyrohet të paraqitet pranë institucionit ku është emëruar, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e marrjes së aktit. Në rast të mosparaqitjes së kandidatit fitues, brenda afatit të përcaktuar në pikën 19/1, të kësaj vendimi, institucioni ku kandidati është emëruar, njofton njësinë përgjegjëse brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i afatit. Në këtë rast njësia përgjegjëse vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ (akti i emërimit), në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. Institucionet detyrohen të nxjerrin aktin e fillimit të efekteve financiare të kandidatit të emëruar nga njësia përgjegjëse, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e paraqitjes së tij pranë institucionit. Ky afat mund të shtyhet me marrëveshje midis të dyja palëve, por jo më shumë se 1 (një) muaj nga data e nxjerrjes së aktit të emërimit nga njësia përgjegjëse.



Shtimi i tarifës kaluese "bllok" turizmin, zbulohen shifrat e INSTAT

# 'Taksa e kombit', 40 mijë turistë më pak nga Kosova

## Krahasimi tetor-nëntor me një vit më parë

Në tetor dhe nëntor, që përkon me periudhën që u vendos taksa e Rrugës së Kombit, hyrjet e shtetasve nga Kosova kanë shënuar rënie të ndjeshme, në krahasim me të njëjtën muaj të një viti më parë.

Sipas të dhënave të INSTAT, në muajin nëntor hynë në Shqipëri rreth 69 mijë shtetas nga Kosova, nga 93 mijë në të njëjtin muaj të një viti më parë, me një tkurrje të ndjeshme prej 27%, ose rreth 25 mijë persona më pak. Edhe në tetor numri i tyre kishte rënë me 11%, ose 15 mijë persona më pak, pra 40 mijë hyrje më pak të shtetasve nga Kosova vetëm për dy muaj. Përjashtuar tetorin dhe nëntorin, fluksi i hyrjes së shtetasve nga Kosova kishte qenë shumë i lartë. Për 10-mujorin, në Shqipëri kanë hyrë 1.9 milionë shtetas nga Kosova, me një rritje gati 22% me bazë vjetore. Ndërsa në mes të muajit shtator filloi aplikimi i takses së rrugës, prej 5 euro për një veturë, që duket se ka ndikuar në frenimin e



lëvizjes së shtetasve nga Kosova, që edhe në periudhën e dimrit vijnë për fundjava në Shqipëri, këtë vit të favorizuar dhe nga moti relativisht i ngrohtë.

Në total, për 11-mujorin, Shqipërinë e vizituan gjithsej 5.6 milionë të huaj, me një rritje prej 16.2% me bazë vjetore. Por, në nëntor, hyrjet në total të të huajve

pushën kryesore, me 36%, ose rreth 2 milionë persona dhe nëse vijon largimi i tyre pritet t'i japë një goditje të rëndë turizmit vendës, sidomos në zonën e Durrësit, që është destinacioni kryesor i tyre. Në vend të dytë janë maqedonasit, me 640 mijë hyrje, ose 11.3% të totalit. Të tretët renditen, me 498 mijë hyrje, ose 8.8% të totalit. Në vend të katërt janë italianët, me 408 mijë hyrje ose 7.2% të totalit. Më pas janë malazezët, me 330 mijë hyrje, ose gati 6% të totalit. 2.7 milionë të huaj kanë ardhur për turizëm në 11 muajt e parë të vitit, ose rreth 48% e totalit, me rritje prej 17% në raport me të njëjtin periudhë të një viti më parë.

### DALJET

Shtetasit shqiptarë dhe

të huaj të dalë nga vendi gjatë muajit nëntor 2018 janë 660.514 duke shënuar një ulje me 6.4%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit nëntor 2018 është 431.279 krahasuar me nëntor 2017, ky numër është rritur 3.0%. Numri i shtetasve të huaj të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit nëntor 2018 është 229.235. Krahasuar me nëntor 2017, ky numër është ulur 20.1%. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në njëmbëdhjetëmuajorin 2018 është 4.969.039, duke u rritur 3.8%, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë, raporton INSTAT.

Monitor.al

Tirana International Airport  
Nënë Tereza

### TENDER NOTIFICATION

#### CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT "AIRFIELD 2020" PROJECT TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for consulting services for construction management of "Airfield 2020" project.

TIA is looking to contract a company that will provide the consulting services which consist of technical and administrative assistance and support on behalf of TIA for monitoring, managing and supervising the construction works that will be part of the "AIRFIELD 2020" PROJECT.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e-mail, to all below e-mail address.

Upon receipt of the e-mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form. The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e-mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked: "CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT" "AIRFIELD 2020" PROJECT

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 11 January 2019.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:  
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

### Zv.ministri i Bujqësisë: Rritet kooperimi i fermerëve

## Kooperimi i shoqërive bujqësore, Halili: Hiqet tavanin për rimbursimin e TVSH-së

Qeveria po nxit krijimin e kooperimit të shoqërive bujqësore (SHBB) si alternativa që siguron qëndrueshmëri, prodhim më të lartë dhe më shumë të ardhura për familjet fermerë. Zv.ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ilir Halili, në një intervistë për Agjencinë Telegrafike Shqiptare (ATSH) tha se, "një masë tjetër e rëndësishme që ka të bëjë me trajtimin e SHBB-ve është heqja e tavanit për rimbursimin e TVSH-së të katër subjekte". Halili shpjegoi se në krahasim me fermerët individualë, që e kanë deri 5 milionë lekë të reja në vit SHBB, tani janë pa këtë tavan, pra mund të jenë pjesë e skemës së rimbursimit të TVSH-së pa një limit. Zv.ministri i Bujqësisë shprehu bindjen se kjo masë do të sjellë një numër të konsiderueshëm shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor në skemë, duke rritur kooperimin e fermerëve në prodhim dhe në shitje.

Përmasë kësaj mase që është përfshirë në paketën e re fiskale 2019, shumë fermerë kanë mundësi të bashkohen në Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor dhe të



kenë një numër NIPT-i, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e shkallës së formalizimit. Deri tani numërohen mbi 100 Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor në të gjithë vendin, mbi kufirin minimal të regjistrimit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), në zbatim të nenit 117, të ligjit nr 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në është garkullimi prej 2,000,000 (dy milionë) lekësh në një vit kalendarik, përveç disa rasteve të përcaktuara, ku bëjnë pjesë edhe SHBB-të. Prodhuesit bujqësorë, për të cilët zbatohet regjimi i veçantë i skemës së kompensimit të fermerëve, por që e

zhvillojnë veprimtarinë ekonomike në kuadrin e një sipërmarrjeje bujqësore të organizuar, si shoqëri e bashkëpunimit bujqësor (SHBB), janë të përjashtuar nga aplikimi i kufirit si më sipër për regjimin e veçantë të skemës së kompensimit, me kushtin që kjo SHBB të kryejë vetëm veprimtari të shitjes së produkteve bujqësore të anëtarëve të saj tatimpagues, që nuk janë pjesë e skemës së kompensimit. Në këtë rast, blerësi, person i tatueshëm, lëshon faturë tatimore vetëm për shitësin, shoqërinë e bashkëpunimit bujqësor, ndërsa kjo e fundit nuk lëshon faturë tatimore, sipas parimeve të kësaj skeme për fermerët anëtarë të SHBB-ve.

TIRANË

Mjekoligjorët: Jeta e të plagosurit në rrezik, duhet të mjekohet në spital civil

Afro tre muaj pas masakrës me një të vrarë dhe dy të plagosur në lokalin "Monopol" në zonën e ish-Bllokut, ekspertët e Mjekësisë Ligjore kanë arrihur në përfundimin se qëndrimi në qelitë e paraburgimit në rrezik jetën e Elion Hatos. Sipas ekspertëve, 28-vjeçari, i cili u plagos mbrëmjen e 4 tetorit të këtij viti duhet të mbahet në ambientet e një spitali civil, ku mund të marrë shërbim të specializuar. Mësohet se i paraburgosuri i është drejtuar gjykatës së Tiranës me kërkesën për ndryshimin e masës së sigurisë, pasi kërkoi të transferohej në një spital në Turqi, ku mund të kryejë një ndërhyrje për heqjen e tre plumbave që ka në trup. Gjykatësi Artan Gjermani e ka administruar në dosje ekspertizën mjekoligjore, por ende nuk ka dalë me një vendim. Kjo për faktin se prokurorët kanë kërkuar kohë për ta shqyrtuar ekspertizën që të mbajnë qëndrimin e tyre pro apo kundër kërkesës së të paraburgosurit. Ndërkohë, lidhur me ngjarjen e ish-Bllokut, prokuroria ka administruar në dosje provën e radhës. Bëhet fjalë për ekspertizën e telefonit të viktimës, Fabian Gaxha, i cili ishte pjesë e grupit të biznesmenit të njohur të pikave të basteve, Ervis Martinaj. Burime nga prokuroria bënë me dije për "News24" se në aparatit celular janë zbuluar disa komunikime në Whats up mes Gaxhës dhe Elion Hatos. Me screen-shotin e një mesazhi të ardhur në telefonin e tij, dërguesin e të cilit është duke e hetuar nga prokuroria, Hato i ka kërkuar Fabian Gaxhës të vijë menjëherë në lokal "Monopol" i pajisur me armë. Sikurse rezultoi në dosje, fill më pas, Gaxha ka hyrë në lokal dhe është konfliktuar me komandon Meviol Bilo, që shoqëronte biznesmenin Ervin Mata. Në debat e sipër 28-vjeçari ka qëlluar me armë. Sulmit i është kundërpërgjigjur Bilo, duke e lënë atë të vrarë, ndërsa të plagosur mbetet Ervis Martinaj dhe Elion Hato, të cilët u ndaluan në spital dhe vijnë të mbahen nën masën e arrestit me burg. Në kërkim për ngjarjen janë tashmë vetëm biznesmeni Ervin Mata dhe komando Meviol Bilo. Të gjithë të arrestuarit e tjerë janë liruar nën masën e detyrimit për paraqitje.

# Vrasja në ish-Bllok, ja prova e re e gjetur në telefonin e viktimës

*Prokuroria: Elion Hato i dërgoi mesazh Gaxhës: Eja me armë në lokalin "Monopol"*



I arrestuari Elion Hato

### PROVA E PROKURORISË

Prokuroria ka administruar në dosje provën e radhës. Bëhet fjalë për ekspertizën e telefonit të viktimës, Fabian Gaxha, i cili ishte pjesë e grupit të biznesmenit të njohur të pikave të basteve, Ervis Martinaj. Burime nga prokuroria bënë me dije për "News24" se në aparatit celular janë zbuluar disa komunikime në Whats up mes Gaxhës dhe Elion Hatos. Me screen-shotin e një mesazhi të ardhur në telefonin e tij, dërguesin e të cilit është duke e hetuar nga prokuroria, Hato i ka kërkuar Fabian Gaxhës të vijë menjëherë në lokal Monopol i pajisur me armë.

### KËRKESA

Sipas ekspertëve mjeko-ligjorë, 28-vjeçari, i cili u plagos mbrëmjen e 4 tetorit të këtij viti duhet të mbahet në ambientet e një spitali civil, ku mund të marrë shërbim të specializuar. Mësohet se i paraburgosuri i është drejtuar gjykatës së Tiranës me kërkesën për ndryshimin e masës së sigurisë, pasi kërkoi të transferohej në një spital në Turqi, ku mund të kryejë një ndërhyrje për heqjen e tre plumbave që ka në trup.



Vendi ku ndodhi masakra e 4 tetorit

## Kush është 28-vjeçari Elion Hato, i dënuar për vrasje

TIRANË - Elion Hato, është një emër i njohur për policinë, pasi rezultoi i dënuar për vrasje me dashje në Shkodër. Injohur ndryshe edhe me emrin Esmeraldo, akuzohet se vrau më 12 maj të vitit 2014 në Shkodër pas një grindje banale 22-vjeçarin Indrit Hylli, si edhe plagosi Jetmir Mollën. Ai u arrestua së bashku me të vëllanë në 3 maj të vitit 2015 në Laç. Gjykata e Shkodrës kishte aktuar masën e arrestit me burg për të dy këta persona. Tre vite pas arrestimit për vrasje me dashje, Eljon Hato shfaqet në zonën e ish-Bllokut në Tiranë ku u përfshi në konfliktin me armë që i mori jetën jetën 28-vjeçarit Fabian Gaxha.



## Dyshohet për larje hesapesh

### Plagoset me plumb në bark, shqiptari në gjendje të rëndë

ITALI - Një 25-vjeçar shqiptar, identiteti i të cilit nuk bëhet me dije është plagosur mbrëmjen e së hënës në Frignano të Italisë. Ai mbërriti në urgjencë në spitalin Moscati të Aversas me një plumb në bark. Mësohet se i riu shqiptar, rezident në Frignano është futur menjëherë në sallën e operacionit të spitalit në fjalë ku i është nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale delikate. Mediat e vendit fqinj dje raportuan se,

gjendja e tij shëndetësore është shumë e rëndë. Rrethanat e ngjarjes ende nuk janë të qarta për policinë, për të vlerësuar nëse është qëlluar gjatë një tentative për grabitje apo gjatë një konflikti të agravuar. Menjëherë pas sinjalizimit për plagosjen e shqiptarit, policia në Komisariatin e Aversas ka nisur hetimet për zbardhjen e krimit duke mbledhur edhe dëshmitë e personave që mund të kenë qenë të pranishëm në momentin e ngjarjes. Gjithash-



tu, mediat italiane bënë me dije se dyshimet e para të policisë janë për larje hesapesh, por mbetet ende për t'u hetuar. Do të jenë hetimet në vijim që do të hedhin dritë mbi rrethanat, motivin dhe autorët e plagosjes së 25-vjeçarit shqiptar.

## Blutë: Ngjarja, nga pakujdesia

### Polici privat plagos me armë zjarri kolegun 32-vjeçar

FIER - Një 32-vjeçar me inicialet E.M., me detyrë trup shërbimi në Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike është plagosur me armë zjarri nga kolegu i tij në Fier. Sipas policisë, ngjarja ka ndodhur dy ditë më parë, kur Adriatik Mehmeti, banues në Fier, gjatë dorëzimit të shërbimit në ambientet e një Shoqërie Private të Sigurisë Fizike, ka shprehur gabimisht armën e shërbimit duke plagosur në këmbë kolegun e tij 32-

vjeçar. Sipas burimeve policore, 58 vjeçari ishte kthyer nga shërbimi në një prej institucioneve që kjo kompani ruante dhe teksa ka bërë çarçatimin dhe po dorëzonte detyrën, arma ka bërë qitje të pavullnetshme. "Në datën 24.12.2018 u referuan materialet në Prokurorinë Pranë Gjykatës Shkallës së Parë Fier për shtetasin A.M., 58 vjeç banues në Fier, me detyrë trup shërbimi në subjektin SHPSF, pasi në ambien-



tet e zyrave të SHPSF së gjatë dorëzimit të shërbimit, dyshohet se nga pakujdesia ka plagosur në këmbë me armën e shërbimit pistoletë, shtetasin E.M. 32 vjeç, banues në Patos, me detyrë trup shërbimi në subjektin SHPSF. I plagosuri është dërguar menjëherë në Spitalin e Fierit ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën

### Bastiste banesa, përfundon në pranga 21-vjeçari

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka vënë në pranga një 21-vjeçar, i cili akuzohet për tentativë vjedhje si dhe për kundërshtim të punonjësve të policisë. Burime zyrtare pohuan se shtetasi me inicialet T.Q., banues në lagjen "5-Maj", dyshohet edhe si autor i katër vjedhjeve të tjera të banesave. Arrestimi u krye, pasi në orët e para të mëngjesit të djeshëm në lagjen "5-Maj", i riu është kapur në flagrancë duke tentuar të vjedhë në banesën e shtetasës Sh.M., banuese në Elbasan. Mësohet se i riu në momentin e shoqërimit ka kundërshtuar shërbimet e policisë.

Sipas burimeve të mësipërme, nga kryerja e veprimeve hetimore ka rezultuar se ky shtetas dyshohet të jetë autor edhe i katër vjedhjeve të kryera më parë, dhe konkretisht: Më datë 20.10.2018, në lagjen "Emin Matraxhiu" Elbasan, dyshohet se ka vjedhur me thyerje banesën e shtetasit E.T., ku kanë marrë 40.000 lekë dhe 200 euro.

Më datë 29.10.2018, gjatë natës në lagjen "Shënkoll" Elbasan, dyshohet se ka vjedhur banesën e shtetasit B.C., ku ka vjedhur 2 televizorë plazma dhe disa vegla pune me vlerë rreth 2000 euro.

Më datë 08.11.2018, dyshohet se ka vjedhur në banesën e shtetasit A.B, ku ka marrë një televizor "Plazma", 32 polësh.

Më datë 20.11.2018, në lagjen "Haxhias" Elbasan, dyshohet se ka vjedhur në banesën e shtetasit M.P., ku ka marrë 70000 lekë dhe disa bizhuteri. Materialet hetimore do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprimet e mëtejshme.



Letra me 11 kërkesa drejtuar kryeministrit, në emër të 7 mijë punonjësve

TIRANË

Përmes një letre drejtuar kryeministrit Rama, që mban datën 18 dhjetor, sindikata e policisë paraqet disa kërkesa me karakter ekonomik. "ABCNews" ka siguruar një kopje të letrës. Punonjësit e Policisë së Shtetit i janë drejtuar kryeministrit Edi Rama me një shkresë ku kërkojnë plotësimin e 11 pikave. Ndër më kryesoret janë paga e 13-të dhe pagesa e orëve shtesë. Dokumenti mban datën 18 dhjetor dhe një kopje e tij u sigurua nga "ABC News". Shkresa u dërgua në emër të 7 mijë efektivëve, sipas të cilëve kushtet e vështira në punë janë bërë të papërbalueshme për ata dhe familjet e tyre. Efektivët e policisë pretendojnë se janë më pak të paguar në krahasim me homologët europianë, ndërsa prej vitit 2014 paga e tyre nuk ka pësuar rritje. Sindikata e policisë vëren se 80% e efektivëve kanë aplikuar për Lotarinë Amerikane, ndërkohë që 70% familjeve të policëve jetojnë nën minimumin jetik - thuhet në shkresë. Punonjësit kërkojnë pagesën e dietave të prapambetura nga 2017-ta. Por, situata është edhe më alarmante për punonjësit e Policisë së Tiranës. Orët suplementare nuk janë paguar nga viti 2016 për disa nga komisarariatet, efektivët e të cilëve kanë qenë të pranishëm në stadiume për ndeshjet kombëtare apo dhe të Superligës. Një pikë tjetër në kërkesat e

# Sindikata e policisë, letër Ramës: Të jepet paga e 13-të dhe pagesa e orëve shtesë

*"Kushtet e vështira në punë janë të papërbalueshme, 80% e efektivëve kanë aplikuar për Lotarinë Amerikane"*

**SITUATA**

Sindikata e policisë vëren se 80% e efektivëve kanë aplikuar për Lotarinë Amerikane, ndërkohë që 70% familjeve të policëve jetojnë nën minimumin jetik - thuhet në shkresë. Punonjësit kërkojnë pagesën e dietave të prapambetura nga 2017. Por situata është edhe më alarmante për punonjësit e Policisë së Tiranës. Orët suplementare nuk janë paguar që nga viti 2016 për disa nga komisarariatet, efektivët e të cilëve kanë qenë të pranishëm në stadiume për ndeshjet kombëtare apo dhe të Superligës.



**SHKRESA**

Punonjësit e Policisë së Shtetit i janë drejtuar kryeministrit Rama me një shkresë, ku kërkojnë plotësimin e 11 pikave. Ndër më kryesoret janë paga e 13-të dhe pagesa e orëve shtesë. Dokumenti mban datën 18 dhjetor dhe një kopje e tij u sigurua nga "ABC News". Shkresa u dërgua në emër të 7 mijë efektivëve, sipas të cilëve kushtet e vështira në punë janë bërë të papërbalueshme për ata dhe familjet e tyre.

sindikatsë së policisë drejtuar shefit të qeverisë është edhe sigurimi i jetës në rast aksidenti në punë dhe përfitimimi i

banesave falas për familjarët e policëve që kanë humbur jetën në krye të detyrës. Në pikën e fundit, kërkesa e

përhershme e punonjësit e policisë: uniforma blu të sigurohet falas dhe zëvendësimi i saj të bëhet pa pagesë, gjë që

nuk ka ndodhur deri tani. Në fund të shkresës, thuhet se është përgjegjësi e administratës së Ministrisë së

Brendshme dhe Policisë së Shtetit që trupat policore të Shqipërisë ndodhen në këtë gjendje.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



# PENSIONET E PLEQËRISË NDRYSHIMET

Voltiza Duro

Formula e llogaritjes, ISSh: Masa, e bazuar në vitet e punës me kontribute dhe pagën

## Si do të ndryshojë mosha e daljes në pension nga janari i 2019-ës

Tabelat e plota të viteve për burrat dhe gratë

P prej janarit të vitit 2019, do të ketë ndryshime të moshës së daljes në pension për të gjithë individët që kanë minimumi 15 vite pune me kontribute. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot moshën e daljes në pension për 2019-ën si dhe 2020-ën. Aktualisht për vitin 2018-të, mosha e daljes në pension sipas nenit 43, për gratë është 60 vite e 8 muaj (rritet për çdo vit me 2 muaj deri në vitin 2056 që arrin në 67 vjeç). Ndërkohë sipas kësaj llogaritjeje, mosha e daljes në pension për gratë në 2019-ën do të jetë 60 vjeç e 10 muaj, ndërsa në 2020 do të jetë 61 vjeç. Ndërkohë, burrat duhet të kenë mbushur moshën 65 vjeç në mënyrë që të përfitojnë pagesën e pensionit të pleqërisë (mosha fillon rritet që nga viti 2033 me nga 1 muaj në vit për të arritur në 67 vjeç në vitin 2056). Në bazë të reformës së vitit 2014-të, masa e përllogaritjes së pensionit varet nga vitet e punës dhe paga, pra pensioni është produkt i viteve të sigurimit dhe pagës mbi të cilin janë paguar kontributet. Sa më shumë vite të ketë aplikanti dhe sa më e lartë të ketë qenë paga e tij, aq më e lartë do të jetë masa e përfitimt. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se vjetërsia e plotë kontributive për të dy gjinitë është 35 vite e 8 muaj, e cila rritet me 4 muaj në vit, për të arritur me 40 vite në vitin 2029. "Personat e siguruar që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të këtij ligji", theksohet në ligjin "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", për sa i përket pensionit të pleqërisë në vendin tonë. Ndërkohë personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension të përcaktuar në nenin 92 kur kanë plotësuar vitet e sigurimit sipas nenit 92; apo nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar. Ndërkaq, nënat që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë të rritur me shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim. "Për të lindur e drejta për pension pleqërie, kërkohen dy kushte, që janë vjetërsia kontributive jo më pak se 15 vite kontributive dhe mosha, që për-

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
01.07.2010 - 30.06.2011	58	31	63v 6m	35	64v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	59	32	64v	35	65v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	59	33	64v 6m	35	65v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	60	34	65v	35	65v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	60v 6m	35	65v	35v	65v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	61v	35v 4m	65v	35v 4m	65v	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	61v 6m	35v 8m	65v	35v 8m	65v	35v 8m

01.01.2017 - 31.12.2017	62v	36v	65v	36v	65v	36v
01.01.2018 - 31.12.2018	62v 6m	36v 4m	65v	36v 4m	65v	36v 4m
01.01.2019 - 31.12.2019	63v	36v 8m	65v	36v 8m	65v	36v 8m
01.01.2020 - 31.12.2020	63v 6m	37v	65v	37v	65v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	64v	37v 4m	65v	37v 4m	65v	37v 4m
01.01.2022 - 31.12.2022	64v 6m	37v 8m	65v	37v 8m	65v	37v 8m
01.01.2023 - 31.12.2023	65v	38v	65v	38v	65v	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	65v	38v 4m	65v	38v 4m	65v	38v 4m
01.01.2025 - 31.12.2025	65v	38v 8m	65v	38v 8m	65v	38v 8m
01.01.2026 - 31.12.2026	65v	39v	65v	39v	65v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	65v	39v 4m	65v	39v 4m	65v	39v 4m
01.01.2028 - 31.12.2028	65v	39v 8m	65v	39v 8m	65v	39v 8m
01.01.2029 - 31.12.2029	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2033 - 31.12.2033	65v 1m	40v	65v 1m	40v	65v 1m	40v
01.01.2034 - 31.12.2034	65v 2m	40v	65v 2m	40v	65v 2m	40v
01.01.2035 - 31.12.2035	65v 3m	40v	65v 3m	40v	65v 3m	40v
01.01.2036 - 31.12.2036	65v 4m	40v	65v 4m	40v	65v 4m	40v
01.01.2037 - 31.12.2037	65v 5m	40v	65v 5m	40v	65v 5m	40v
01.01.2038 - 31.12.2038	65v 6m	40v	65v 6m	40v	65v 6m	40v
01.01.2039 - 31.12.2039	65v 7m	40v	65v 7m	40v	65v 7m	40v

31.12.2039						
01.01.2040 - 31.12.2040	65v 8m	40v	65v 8m	40v	65v 8m	40v
01.01.2041 - 31.12.2041	65v 9m	40v	65v 9m	40v	65v 9m	40v
01.01.2042 - 31.12.2042	65v 10m	40v	65v 10m	40v	65v 10m	40v
01.01.2043 - 31.12.2043	65v 11m	40v	65v 11m	40v	65v 11m	40v
01.01.2044 - 31.12.2044	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2045 - 31.12.2045	66v 1m	40v	66v 1m	40v	66v 1m	40v
01.01.2046 - 31.12.2046	66v 2m	40v	66v 2m	40v	66v 2m	40v
01.01.2047 - 31.12.2047	66v 3m	40v	66v 3m	40v	66v 3m	40v
01.01.2048 - 31.12.2048	66v 4m	40v	66v 4m	40v	66v 4m	40v
01.01.2049 - 31.12.2049	66v 5m	40v	66v 5m	40v	66v 5m	40v
01.01.2050 - 31.12.2050	66v 6m	40v	66v 6m	40v	66v 6m	40v
01.01.2051 - 31.12.2051	66v 7m	40v	66v 7m	40v	66v 7m	40v
01.01.2052 - 31.12.2052	66v 8m	40v	66v 8m	40v	66v 8m	40v
01.01.2053 - 31.12.2053	66v 9m	40v	66v 9m	40v	66v 9m	40v
01.01.2054 - 31.12.2054	66v 10m	40v	66v 10m	40v	66v 10m	40v
01.01.2055 - 31.12.2055	66v 11m	40v	66v 11m	40v	66v 11m	40v
01.01.2056 - 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

caktohet sipas tabelës së paraqitur në nenin 43 të ligjit (që ndryshon nenin 92).

### FORMULA E LLOGARITJES

Për llogaritjen e pensionit të pleqërisë sipas ligjit 104/2014, neni 18, i cili ndryshon nenin 32 të ligjit 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Sh-

qipërisë" përcaktohet si më poshtë: Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Ndërkohë shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit që ka realizuar personi me periudhën e sigurimit të kërkuar sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social. Ndërsa shtesa do të jetë 1 për qind për vit sig-

urimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 31 të ligjit 104/2014 (i cili ndryshon nenin 59 të ligjit 7703 datë 11.05.1993). Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social. Kjo e fundit bën me dije për të gjithë të intere-

suarit se për ta patur sa më të qartë këtë përllogaritje, është e nevojshme të dihet se çfarë përfaqëson pensioni social. Ndërkohë, sipas ligjit 104/2014, pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kush-



vet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura, ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social. Masa e këtij pensioni social është e barabartë me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë me 15 vite të siguruar me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014. Ndërsa masa e pensionit social për personat që kanë të ardhura nga burime të tjera, do të jetë sa diferenca e pensionit social me të ardhurat e tjera që ka përfituesi. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pensionin social përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për llogaritjen e pensionit përdoret formula: PP (Pension i pleqërisë) = PS (Pension Social) \* (shumëzuar) vjetërsi kontributive të realizuara / vjetërsi kontributive që kërkohet + 1/100\* (shumëzuar) vite sigurimi\* (shumëzuar) BV ( baza e vlerësuar)

### BAZA E VLERËSUAR

Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data





**KUSHTET**

Të gjithë ata persona që kanë plotësuar moshën dhe kenë minimumi 15 vite pune me kontribute mund të përfitojnë pension pleqërie. Përkatesisht burrat duhet të jenë mbi 65 vjeç, ndërsa gratë mbi 60 vjeç e 8 muaj në mënyrë që të mund të marrin këtë lloj pagese.

1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit si ish-punonjës i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomiksht aktiv pas datës 01.01.1994. Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2016 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës

ose funksionit përpara datës 01.01.1994 si edhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2015, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2015 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koefficientet e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Koefficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8,59.

**SHEMBUJ KONKRETE**

Për ta konkretizuar këtë problem po të marrim një pagë referuese për një specialist të lartë në ndërmarrje ekonomike, që aktualisht është e miratuar në masën 4.192 lekë, duke e shumëzuar me koefficientin 8,59, e indeksuar deri në periudhën aktuale jep një pagë prej 36.009 lekë. Ndërsa mbas vitit 1994, merren pagat respektive sipas viteve, të cilat duke u shumëzuar me koefficientët përkatës, japin pagën për efekt të llogaritjes së pensionit. Po të marrim një

**b) PËR GRATË**

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
01.07.2011 - 30.06.2012	54	32	59v	35	60v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	54	33	59v 6m	35	60v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	55	34	60v	35	60v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	55v 6m	35	60v	35	60v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	56v	35	60v 2m	35v4m	60v2m	35v4m
01.01.2016 - 31.12.2016	56v 6m	35	60v4m	35v8m	60v4m	35v8m
01.01.2017 -	57v	35	60v6m	36v	60v6m	36v

30.12.2017						
01.01.2018 - 30.06.2018	57v 6m	35	60v8m	36v4m	60v8m	36v4m
01.01.2019 - 31.12.2019	58v	35	60v10m	36v8m	60v10m	36v8m
01.01.2020 - 31.12.2020	58v 6m	35	61v	37v	61v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	59v	35	61v2m	37v4m	61v2m	37v4m
01.01.2022 - 31.12.2022	59v 6m	35	61v4m	37v8m	61v4m	37v8m
01.01.2023 - 31.12.2023	60v	35	61v6m	38v	61v6m	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	60v4m	35v6m	61v8m	38v4m	61v8m	38v4m
01.01.2025 - 31.12.2025	60v8m	36v	61v10m	38v8m	61v10m	38v8m
01.01.2026 - 31.12.2026	61v	36v6m	62v	39v	62v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	61v4m	37v	62v2m	39v4m	62v2m	39v4m
01.01.2028 - 31.12.2028	61v8m	37v6m	62v4m	39v8m	62v4m	39v8m
01.01.2029 - 31.12.2029	62v	38v	62v6m	40v	62v6m	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	62v4m	38v6m	62v8m	40v	62v8m	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	62v8m	39v	62v10m	40v	62v10m	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2033 - 31.12.2033	63v 2m	40v	63v 2m	40v	63v 2m	40v
01.01.2034 - 31.12.2034	63v 4m	40v	63v 4m	40v	63v 4m	40v
01.01.2035 - 31.12.2035	63v 6m	40v	63v 6m	40v	63v 6m	40v
01.01.2036 - 31.12.2036	63v 8m	40v	63v 8m	40v	63v 8m	40v
01.01.2037 - 31.12.2037	63v10m	40v	63v10m	40v	63v10m	40v
01.01.2038 - 31.12.2038	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2039 - 31.12.2039	64v2m	40v	64v2m	40v	64v2m	40v

01.01.2040 - 31.12.2040	64v4m	40v	64v4m	40v	64v4m	40v
01.01.2041 - 31.12.2041	64v6m	40v	64v6m	40v	64v6m	40v
01.01.2042 - 31.12.2042	64v8m	40v	64v8m	40v	64v8m	40v
01.01.2043 - 31.12.2043	64v10m	40v	64v10m	40v	64v10m	40v
01.01.2044 - 31.12.2044	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2045 - 31.12.2045	65v2m	40v	65v2m	40v	65v2m	40v
01.01.2046 - 31.12.2046	65v4m	40v	65v4m	40v	65v4m	40v
01.01.2047 - 31.12.2047	65v6m	40v	65v6m	40v	65v6m	40v
01.01.2048 - 31.12.2048	65v8m	40v	65v8m	40v	65v8m	40v
01.01.2049 - 31.12.2049	65v10m	40v	65v10m	40v	65v10m	40v
01.01.2050 - 31.12.2050	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2051 - 31.12.2051	66v2m	40v	66v2m	40v	66v2m	40v
01.01.2052 - 31.12.2052	66v4m	40v	66v4m	40v	66v4m	40v
01.01.2053 - 31.12.2053	66v6m	40v	66v6m	40v	66v6m	40v
01.01.2054 - 31.12.2054	66v8m	40v	66v8m	40v	66v8m	40v
01.01.2055 - 31.12.2055	66v10m	40v	66v10m	40v	66v10m	40v
01.01.2056 - 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

rast konkret; në vitin 2008, paga minimale ka qenë 14 830 lekë, duke u shumëzuar me koefficientin e indeksimit (i cili miratohet çdo vit me VKM), që është 1,48 jep pagën minimale prej 22.000 lekë. Po kështu dhe paga maksimale e cila ka qenë 74.150, kur shumëzohet me po këtë koefficient indeksimi jep pagën maksimale aktuale 97.030. Sigurisht pagat e ndërmjetme, me indeksimin sipas koefficientëve përkatës, do të na japin paga aktuale ndërmjet minimale e maksimales. Në rast se marrim në mënyrë hipotetike që një punonjës para vitit 1994 ka një vjetërsi kontributive prej 15 vitesh dhe paga mesatare e indeksuar rezultojn në një shumë prej 25 000 lekë dhe mbas vitit 1994 ka një vjetërsi kontributive prej 22 vite me një pagë mesatare të indeksuar prej 30 000 lekësh, atëherë baza e vlerësuar do të llogaritet:

**Baza e vlerësuar** = (15\*25.000 lekë + 22 \* 30.000 lekë) : 37 (vite gjithsej) = 28.000 lekë. Pensioni mujor = ( 6.750 \*37/35,7 ) + (1/100 \*37\*28.000) = 6.996 + 10.360 = 17.356 lekë. Sipas nenit 33 të ligjit 104/2014, i siguruarit, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie sipas nenit 43 të këtij ligji, merr shtesë në masën 0,5 përqind të pensionit për çdo muaj që shtyn datën e daljes në pension dhe vazhdon të paguajë kontribute. Përfutuesi i pensionit të pleqërisë, që ndërpret pensionin, vazhdon të punojë dhe paguan kontribute, merr shtesë mbi pension në masën 0,5 për qind për çdo muaj ndërprejeje. Kjo shtesë llogaritet mbi atë masë në pensioni që rezultojn pas rritjeve dhe indeksimit që ka pësuar pensioni gjatë kohës së ndërprejes. Në rastin e mësipërm, në qoftë se, ky person ka punuar mbi moshë për një periudhë prej 1 viti e 6 muaj, shtesa mbi

pension do të llogaritet, 18 muaj \* 0,5 = 9% \* 17.356 = 1.562 lekë. Në këto kushte pensioni që do të përfitonet aplikuesi do të ishte i barabartë me shumën: 17.356 + 1.562 = 18.918 lekë.

**KOEFIKIENTI E INDEKSIMIT**

Koefficientet e indeksimit janë ata koefficientë që kërkojnë që pagën mbi të cilën janë paguar kontributet, ta aktualizojnë e ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra ti heqin efektin "gërryes" të inflacionit. Paga e një mësuesi që ka filluar punën me kontribute në 1975-ën, deri në janar në 94-ën, me gjithë indeksat e ndryshimit që kanë ndodhur, është e tillë që shkon 4110 lekë. Kjo pagë, indeksohet sot me një koefficient 8,59. Pra ajo pagë mësuesi që ka qenë 7 mijë lekë të vjetra, po ta aktualizojmë sot del 360 mijë lekë të vjetra. Edhe ky indeks sot është i përshtatshëm, e fillojnë nga 94' deri në momentin që

del në pension. Viti 2018 nuk ka indeks, kurse viti 2014, 2015 kanë koefficientet respektive. Ndërkohë pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kujë ponderohet me vitet e punës. Individit edhe mund të ketë ndryshuar pozicion pune që ka pasur rrogë më të lartë, por edhe kjo indeksohet e del vlerë më e lartë. Në këto kushte gjithë periudha ponderohet, e individit i del një pagë mesatare bazë e vlerësuar shteshe, e cila shumëzohet me 40%, në rastet kur ka punuar 40 vite (1% për çdo vit pune). Pas kësaj del një vlerë së cilës i shtojmë edhe pensionin social dhe marrim vlerën përfundimtare të pensionit të pleqërisë. Nëse baza mesatare e vlerësuar del në vlerë më të madhe, po ashtu do të rezultojë edhe pensioni.

Qeveria miraton vendimin për kompensimin financiar të atyre që u janë zënë tokat nga "informalët"

# Emrat e pronarëve, si ndahen 6 milionë euro

## ALUIZNI publikon listën e përfituesve në Tiranë, Elbasan, Vlorë, etj

Këshilli i Ministrave ka miratuar përdje vendimin për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet informale në drejtoritë e ALUIZNI-t: Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Tiranë Rurale, Sarandë,

Shkodër, Lezhë, Fshatra Turistikë dhe Kamzë Vorë. Dje, ALUIZNI bëri publik emrat e përfituesve.

Masa e kompensimit është 59 975,25 m<sup>2</sup> dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 801 927 925,69 lekë. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga

ndërtimet pa leje shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave, pas miratimit nga kreditori. Gjithashtu, për një sërë parcelash, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të shkakut të kufizimit.

### AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAV/NDERTIMEVE INFORMALE

#### LISTA EMERORE E SUBJEKTEVE QE PREKEN NGA NDERTIMET INFORMALE TE KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPERBLIMIT

Emër	Atesi	Mbiemër	Emër	Atesi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	
ISMET	SHERIF	MANA	637	BARDHUL	FATMIR	HAXHIBHYSENI	490.1	12.764	6.255.636.40
			638	BALLKYZ	ISMAIL	HAXHIBHYSENI			
			639	FLORESH A	ISMAIL	HAXHIBHYSENI			
			640	ARBEN	FATMIR	HAXHIBHYSENI			
			641	BARDHUL	FATMIR	HAXHIBHYSENI			
			642	BALLKYZ	ISMAIL	HAXHIBHYSENI			
SEFEDIN	HALIM	HASA	643	FLORESH A	ISMAIL	HAXHIBHYSENI	472.4	12.764	6.029.713.60
			644	ARBEN	FATMIR	HAXHIBHYSENI			
			645	AHMET	ZENELHOVHA				
BAJRAM	HASAN	MUÇA	646	KAMBER		MEHLIA	319.70	12.764	4.080.650.80
ARBEN	SABRI	KUKA	647	MEHMET	SULEJMAN	MITARLJA	568.50	12.764.00	7.256.334.00
YMER	XHEHAL	ELEZI							
NDERIM	YMER	ELEZI							
MEVLAN	BEDRI	KAZA							
DRITAN	BEDRI	KAZA							
REFAT	SHAHIN	PISHA	648	MUSTAFA		BYLYKBASHI	478.70	12.764	6.110.126.80
			649	HYQMET		XHERRI			
			650	LINDITA		QEVANI			
			651	MERITA		KARAJ			
			652	MATEO		XHERRI			
			653	EMIN		XHERRI			
NAIM	ISLAM	KAÇULI	654	VALBONA		QEVANI	917.50	12.764.00	11.710.970.00
RAMAZAN	SELM	LEKA	655	MAHMUT		DORACI	106.30	12.764	1.356.813.20
			656	MUSTAFA		BYLYKBASHI			
			657	HYQMET		XHERRI			
			658	LINDITA		QEVANI			
			659	MERITA		KARAJ			
			660	EMIN		XHERRI			
			661	VALBONA		QEVANI			

Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar			Numbri i Pronarëve që kompensohen	Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atesi	Mbiemër	Emër	Atesi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)		
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17	
TIRANË JUG										
QARKU TIRANË, ZVRPP TIRANË, ZONA KADASTRALE 2380										
PERPARIM	XHEVDET	TAKAJ	686	SHPETIM	SHABAN	KARAJ	488.60	507	247.720.20	
QARKU TIRANË, ZVRPP TIRANË, ZONA KADASTRALE 3321										
			687	CEZAR		BESHIRI				
			689	PETRIT		BESHIRI				
QARKU TIRANË, ZVRPP TIRANË, ZONA KADASTRALE 8190										
BESHNIK	HAMIT	KOLAVERI	707	LIZA		MATJARYAJRIMI A	257.60	33.755	8.695.288.00	
XHELIL	SHEFKI	SHINI	708	LIZA		MATJARYAJRIMI A	96.70	33.755	3.284.108.50	
			709	KRESHNIK	SHABAN	LUSHAJ	51.70	33.755	1.745.133.50	
			710	NIMETE		CELA	43.80	33.755	1.478.469.00	
			711	GEZM		HYSA				
			712	LIJAN		MUMAJESI				
			713	SOKOL		CELA				
			714	HATVHE		MUMAJESI				
			715	SILVANA		KAMI				
			716	JETMIRA		HOVHA				
			717	ASTRIT		KAMI				
			718	FATMIR		MUMAJESI				
			719	AISHE		MUMAJESI				
BASHKIM	ASLLAN	QJONI	720	AGIM		MUMAJESI	180.50	33.755	6.092.777.50	



Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar			Numri i Pronareve qe kompensohen	Kompensimi i Pronareve						
Emër	Atësi	Mbiemër		Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17	
			721	REXHEP		KAMR				
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 2105</b>										
GRIGORIS	KAMBER	PRIFTI	722	YLLSON	RIZA	AGOLLI				
			723	DASHNOR	AJAZ	VISHA				
			724	SHKELQIM	QAMIL	KUPA	43.90	4.242	186.223.80	
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 3976</b>										
XHEVIT	AHMET	SALLAKU	725	NAILE		MUMAJESI				
			726	BARDHYL		MUMAJESI				
			727	BAJRAM		MUMAJESI				
			728	MUBAREQ		MUMAJESI				
			729	ALBANA	SELFO	DEMI				
			730	BASHKIM	RESHIT	ARBANA				
			731	ISLAM	RESHIT	ARBANA				
			732	ARMANDO	SELFO	MOSHO				
			733	ELVIE	RESHIT	VOGLI				
			734	MAKSIM	MUHAMMEDI	MUMAJESI				
			735	MIRIAM	MITHAT	MUMAJESI				
736	MILUKA	MITHAT	LATA							
737	EDMOND	MITHAT	MUMAJESI	389.50		186.570.50				
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 3321</b>										
ARBEN	HAMIT	MALKOLLARI	738	DASHAMIR		DERVISHI	261.00	2.560	668.160.00	
SKENDER	LUL	HARIZI	739	DASHAMIR		DERVISHI	407.00	2.560	1,041,920.00	
PETRIT	M EFAIL	DUKA	740	IBRAHIM	IDRIZ	CULLHAJ	163.20	2.560	417.792.00	
ENGJELL	DYLEMAN	CELMETA	741	ARDIAN	ABDULLA	MUÇA	309.90	2.560	793.344.00	
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8180</b>										
ALI	RIZA	META	742	KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE			368	31270	11,507,360.00	
MEDI	RIZA	METAJ		KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE			46.8	31270	1,463,436.00	
ERLET	MYQEREM	MALE		744	ADRIAN	FEJZO	FEJZO	263	31270	8,224,010.00
				745	LILJANA	FEJZO	FEJZO			
				746	MALINDA	FEJZO	FEJZO			
				747	SHPPRESA	FEJZO	FEJZO			
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 3976</b>										
BESHIK	ABAZ	HIDRI	748	ISMAL	KASEM	SPAJA	68.00	479	32,572.00	
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8190</b>										
Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar			Numri i Pronareve qe kompensohen	Kompensimi i Pronareve						
Emër	Atësi	Mbiemër		Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17	
AGRON	SHYQERI	SULA	749	HATEM		HOQHA	50.3	33755	1,697,076.50	
			750	IBRAHIM		HOQHA				
			751	AIDA		FRASHERI(BESHQI)				
			752	ARDIAN		TOPTANI				
			753	BEHUE		ALDA(TOPTANI)				
			754	FADIL		TOPTANI				
			755	MELEQ		FRASHERI				
			756	MYNYRE		TOPTANI				
			757	NADIA		FRASHERI				
			758	NIRVANA		(FRASHERI)LEKAJ				
			759	XHEMLE		TOPTANI	10.7		33755	361,178.50
<b>TIRANE SHITESAT</b>										
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8110</b>										
FESTIM	ALI	GUZI	760	AGRON	GANI	DELIU				
			761	SKENDER	RUSTEM	DELIU				
			762	AIDA	GANI	DELIU				
			763	BEDRIE	XHEMAL	HAJDARI				
			764	BILAL	AZIS	DELIU				
			765	EDLIRA	GANI	MURATAJ				
			766	FATIME	RUSTEM	SHIMA				
			767	KBAL	SEID	DELIU				
ARBEN	ALI	ÇIKA	768	ISLAM	RUSTEM	DELIU				
			769	MURUE	ABDULLA	DELIU	422.27	23703	10,009,065.81	

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8210									
Emër	Atësi	Mbiemër	Numri i Pronareve qe kompensohen	Kompensimi i Pronareve					
				Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
FATLUM	HASAN	MUSHAN	770	ALTIN	LULZIM	FORTUZI			
			771	ARBEN	XHEMAL	FORTUZI			
			772	AURORA		PAPA (MEZINI NEXHIP)			
			773	BEQIR	RAMAZAN	XHEPA			
			774	ERNAL	LULZIM	FORTUZI			
			775	EVA	MEHMET	SHKEMBI			
			776	FATOS	XHEMAL	FORTUZI			
			777	FLORA		LLUKMANI (MEZINI XHEPA)			
KOZETA	TOME	BABOÇI	778	GEZIM	SULEJMAN	XHEPA			
			779	HAJRIE	HAJREDIN	XHEPA	27.72		38614
<b>Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar</b>									
Emër	Atësi	Mbiemër	Numri i Pronareve qe kompensohen	Kompensimi i Pronareve					
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
ARTAN	SINAN	BASHO	780	ILIR	MEHMET	SHKEMBI			
			781	LEJLA	XHEMAL	FORTUZI			
			782	LIRIJE		JOCA (XHEPA RAMAZAN) FORTUZI			
			783	MAHMUDIJE		HAXHI			
			784	MANJOLA		RECA (SHKEMBI XHEPA)			
			785	MARGARITA		ZOI			
			786	MIRLINDA		ZAJMAJ (XHEPA SULEJMAN) TUFIRIA			
			787	MYZEJEN		XHEPA			
HATEME	SHAQO	LULA	788	INDRIGIM	XHAVIT	XHEPA			
			789	SOKOL	XHAVIT	XHEPA			
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8270</b>									
VLADIMIR	THEODHOR	TAÇE	790	ADIVUE	NEXHAT	HYDI			
			791	ASTRIT	NEXHAT	HYDI			
			792	BEHËT	NAMIK	HYDI			
QAZIM	HYSEN	ABDIHOXA	793	ERMIRA	HASAN	HYDI			
			794	KUTIM	NEXHAT	HYDI			
ADRIATIK	FAIK	LAMÇE	795	LIRI	NAMIK	HYDI			
			796	MENSUR	NEXHAT	HYDI			
ERIKETA	JORGJI	LAMÇE	797	MIRIAM	NAMIK	HYDI			
			798	MYNYRE	ISAN	HYDI			
FERDIHAN D	ISUF	HAXHIU	799	NEVIN	HASAN	HYDI			
			800	PEQER	ISAN	HYDI			
ARBEN	REFIT	RUSHITI	801	REZEAR	HASAN	HYDI			
							69.00	66969	4,620,861.00
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8260</b>									
BILBIL	HYSNI	MURATAJ	802	AFERDITA	QAZIM	VORPSI			
			803	ALDA	KUTIM	KIKA			
			804	ARJETA	MUHAMMEDI	DALUPI			
			805	AVENIR	ALI	KIKA			
			806	BARDHYL	ALI	KIKA			
			807	FLUTRA	QAZIM	KIKA			
			808	HALL	QAZIM	KIKA			
			809	KLEJDA	KUTIM	KIKA			
EDUART	ARANIT	REXHEPAJ	810	LIRI	QAZIM	KIKA			
			811	LULEZIM	QAZIM	KIKA			
PETRIT	XHEMAL	MALINDI	812	SADETE	SHABAN	KIKA	26.10	30783	803,436.30
<b>Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar</b>									
Emër	Atësi	Mbiemër	Numri i Pronareve qe kompensohen	Kompensimi i Pronareve					
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
ADRIAN	PETRIT	MALINDI	813	SOKOL	MUHAMMEDI	KIKA			
			814	VERA		KIKA			
			815	VJOLLCA	QAZIM	VORPSI			
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8260</b>									
LUAN	SKENDER	BAKU	816	AFERDITA		VORPSI			
			817	ALDA		KIKA			
			818	ARJETA		PLESHTI			
			819	AVENIR		KIKA			
			820	BARDHYL		KIKA			
			821	FLUTURA		KIKA			
			822	HALL		KIKA			
			823	KLEJDA		KIKA			
			824	LIRI		KIKA			
			825	LULEZIM		KIKA			
			826	SADETE		KIKA			
			827	SOKOL		KIKA			
			828	VERA		KIKA			
			829	VJOLLCA		KIKA	17.50		30783



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE**

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" shpall:

- 1 (një) vend vakant për "Këshilltar Ligjor" me afat sa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,
- 1 (një) vend vakant për "Këshilltar Ligjor" me afat jo më pak se 6 (gjashtë) muaj dhe jo më shumë se 1 (një) vit.

**KËRKESA TË POSAÇME:**

- a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;
- b) Të ketë një përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose administratën publike jo më pak se 7 vjet;
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, si dhe për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
- e) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME**

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 24 dhjetor 2018 deri më 10 janar 2019 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 janar 2019, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 24 dhjetor 2018 deri më 10 janar 2019 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike**, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**RISHPALLJE VENDI VAKANT**

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" rishpall vendin vakant për pozicionin:

**"Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun**

**KËRKESA TË POSAÇME:**

1. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip;
2. Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
3. Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME**

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 24 dhjetor deri më 10 janar 2019 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet

përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 janar 2019, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 24 dhjetor deri më 10 janar 2019 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike**, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.



# VIP

Suplement  
*Pages*

E mërkurë 26 Dhjetor 2016 GAZETA SHQIPTARE

## "BULEVARDI POLITIK"

- Elisa e ka marrë seriozisht ftesën e ministres për të lexuar libra
- Bledi Çuçi nga shapkat me gisht, te këmishat me lule
- Spartak Braho nuk e harron LSI-në, takohet me ish- kolegët
- Sherri në emisionin 'live', deputeti i vërsulet analistit me grushte e shkop

Festa unike në shtëpinë e këngëtares, Zajmina publikon foto të vajzës së saj me vajzat e burrit



E keni parë babain e Arbana Osmanit? Ai fitoi titullin si Babagjyshi



# Katerina Zoto:



## Ja çfarë është 'in' këtë sezon

*"Kam një stil romantik, të kombinuar me nota mashkulllore"*

Flet stilistja: Veshjet me materiale jo cilësore duhet të zhduken nga garderoba

# Aromë festash, rrëfëhet Katerina Zoto: Ja çfarë është 'in' këtë sezon

*"Kam një stil romantik, të kombinuar me nota mashkullore"*

Tashmë nëpër rrjetet sociale nuk shohim vetëm të njëjtat modele veshjesh, por edhe njerëz të ndryshëm që janë bërë 'copy-paste' i njëritjetrit dhe nuk po arrijmë më të dallojmë origjinalen. Për të na dhënë një opinion të saj, sidomos duke qenë se jemi në atmosferë festash, në një intervistë për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", stilistja Katerina Zoto na jep disa ide tepër të veçanta. Duke qenë se sot do të prezantojë edhe sfilatën e saj të parë me koleksionin 2018-2019, me veshje tepër klasike të veçanta, Katerina na jep sugjerime unike për këtë periudhë të vitit. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.

Pamela Aliaj

Jeni një stiliste me një shije të veçantë mode dhe pedagoge në këtë fushë. Si nisi pasioni juaj për modën?

Faleminderit për intervistën dhe vëmendjen tuaj! Pasioni nisi pa vetëdije, duke u identifikuar nga të tjerët, duke ma vënë gjithmonë në dukje të veshurën ndryshe. Unë kam dashur gjithmonë të bëja një punë që të lidhte me skenën dhe sot pikërisht kjo është arsyeja pse punoj fort.

Në cilin lloj stili e gjeni më tepër veten?

Unë kam një stil që as vetë nuk ia di emrin, (qesh) sepse pak a shumë është si arti, që jo gjithmonë shpjegohet. Unë kam një stil romantik të kombinuar me nota mashkullore.

Së shpejti do të prezantoni edhe sfilatën tuaj të parë me veshje. Nga u frymëzuat për të dhe çfarë përfaqëson ajo për ju?

Në fakt, mora një ftesë nga bashkia për të sjellë një sfilatë në Korçë, si një talent i ri i Korçës, që mban gjallë traditën e të veshurit me sharm. Dhe njëkohësisht edhe nga komiteti "Kafe Muzeum" në Korçë, ku do të bëjmë një 'fashion-party' direkt pas sfilatës. Ftesa nga njerëzit bujarë të Korçës ma mbushi shpirtin shumë më tepër sepse është një sfilatë e organi-




zuar nga vetë unë dhe jam tepër e nderuar për këtë. **A keni ndonjë muzë tek e cila frymëzoheni në veshjet tuaja?** Kam stilistë që më pëlqejnë tepër si psh., Enada At Nilolla. E adhuroj! (e kemi dhe korçare për më tepër) Por frymëzimi më vjen natyrshëm, nuk mund të them që frymëzohem nga stilistë të tjerë, më vjen frymëzimi edhe në gjumë. Duke qenë se jemi në atmosferë festash, çfarë do të sugjeroni për mbërmjet festive?

**Sugjeri një veshje që identifikon dhe nxjerr në pah një bukuri femërore të shëndetshme dmth., jo veshje të ekspozuara tepër dhe të parehatshme.** Cili është kombinimi më i

mirë sipas jush në këtë stinë për të qenë i veshur ngrohtë, por edhe me stil? Do të sugjeroja kostume të rehatshme me ndricim, fustane me dantella e detaje të imta që nuk bëjnë zhurmë, por që tregojnë sofistikim. Pantallona klasike, këmishë, bluzë e gjatë, pra një veshje e shtrëshëzuar, këpuçë loafers (stil mashkullor), një pallto oversize dhe fongo apo aksesoret me perla për flokët.

**A ka ndryshuar mënyra e të veshurit te shqiptarët në dallim me disa vite me parë?**

Ka ndryshuar edhe për mirë, edhe për keq. Për mirë shohim vajza të veshura sport, thjesht nëpër shkolla e në përditshmëri me pak taka, kurse ka



ndryshuar pak për keq, sepse duke parë gjithë ditën kombinimet nëpër rrjetet sociale, veçanërisht "Instagram" shohim shumë vajza njësoj të veshura, duke humbur identitetin e vet e duke u bërë kopje e njëra-tjetrës. Këtu mendoj se duhet të ndodhë një revolucion. **Si përfundim, mund të na thoni disa këshilla në mënyrën e të veshurit**

**për këto ditë të ftohta? Çfarë është "in" më tepër sipas jush e çfarë duhet të "zhdukim" nga garderoba për këtë sezon?**

Veshjet me materiale jo cilësore duhet të zhduken nga garderoba. Jam e mendimit: më mirë 2 veshje të sakta e të pastra se sa shumë e për lumë. Veshjet ekstravagante shumë të ngushta e shumë të shkurtra me dekolte, shumë të hapura për mua janë të shëmtuara. Është 'in' çdo gjë për ata që dinë të kombinohen dhe kanë guxim. Moda kohët e fundit na servit shumë gjëra. Vetë ne jemi

përzgjedhës. Mendoj që idealja është që në garderobë të kemi veshje stili, të cilat duken bukur dhe në përditshmëri dhe për neve të vetëm duke luajtur me këpuçët, aksesoret dhe "make up"-in, sepse gjërat stil kanë prerje interesante, shpeshherë të çuditshme dhe na bëjnë të dukemi bukur kudo jemi. Dua t'u kujtoj lexuesve që ka ikur koha e të rënit në sy dhe të dukurit kilometra larg. Thjeshtësia dhe klasi fiton pikë! Por sigurisht kur flasim për gjëra të thjeshta duhet të jenë tepër cilësore që të jenë në nivelin e duhur.





## LUANA DHE KRENARI TË NDARË? ASPAK! JA KU KAPEN "MAT" PËR KRISHTLINDJE

**E**dhe pse prej kohësh mendohet se Luana Vjollca dhe Krenar Çoçaj ishin ndarë, kohët e fundit një detaj i fundit i kapur nga një media rozë i hodhi poshtë të gjitha thashethemet. Disa javë më parë çifti u përfol për ndarje, pasi nuk e ndiqnin më njëri-tjetrin në rrjetin social "Instagram" dhe u aludua se marrëdhënia e tyre e dashurisë kishte marrë fund. Mirëpo, mbrëmjen e 24 dhjetorit ata janë kapur mat nga "Prive", teksa festonin së bashku Krishtlindjet. Luana dhe Krenari janë fotografuar në Katedralen Shën Nënë Tereza në Prishtinë, ku moderatorja kishte shkuar për të qenë pranë partnerit të saj. Epo ku ka më bukur sesa afër të dashurit të



## FESTA UNIKE NË SHITËPINË E KËNGËTARES, ZAJMINA PUBLIKON FOTO TË VAJZËS SË SAJ ME VAJZAT E BURRIT

**D**je ka qenë një nga ditët më të veçanta të gjithë vitit dhe çdokush e feston në mënyrën e vet në familje pranë të dashurve të tyre. Dhe të gjithë ne, përfshirë dhe VIP-at postojnë foto në "Instagram" nga momentet e tyre të veçanta të Krishtlindjes. Ndër fotografitë e shumta nga të famshmit, edhe këngëtarja nga Shqipëria, Zajmina ka postuar dy fotografi nga ato që ka realizuar për festat e fundvitit. Përveç fotografisë me vajzën e saj, ajo postoi edhe një tjetër, ku shihet Khloe me dy motrat e saj të mëdha nga babai. "Gëzuar Krishtlindjet nga familja jonë tek e juaja", ka shkruar Zaj postitë postimit. Një kartolinë shumë e veçantë!



## JO VETËM PËR KRISHTLINDJE, BLERO DHE AFRONA KANË NJË ARSYE MË SHUMË PËR TË FESTUAR

**S**i çdo Krishtlindjeve, Blero Muharremit dhe Afrona Dikës u shtohet një tjetër festë, ajo e përvjetorit të fejesës. Përmes llogarive në "Instagram", të dashuruarit nuk i kanë kursyer dedikimet ndaj njëri-tjetrit. "Falënderoj Zotin për jetën që ndajmë bashkë. Dhe mbi të gjitha, që e ndaj me ty! Gëzuar përvjetorin! Dita e fejesës", shkruan këngëtarja. Afrona nga ana tjetër shprehet: "Një tjetër vit fantastik i fejesës sonë... Gëzuar përvjetorin beb dhe sa më shumë kohë të bukura të kaluara bashkë paçim! Të dua". Pas një marrëdhënie shumëvjeçare, shoqëruar me ulje-ngritje, çifti pritet të kurorëzohet dashurinë më 21 shtator të 2019-ës.



## E KENI PARË BABAIN E ARBANA OSMANIT? AI FITOI TTULLIN SI BABAGJYSHI MË 'COOL' KËTË VIT!

**K**rishtlindja është një festë që të ngroh zemrat dhe të afron me njerëzit e dashur e familjarët. Një gjë të tillë e ka bërë dhe Arbana Osmani. Ajo ka pasur një Krishtlindje shumë të veçantë këtë vit, sepse në familjen e saj ka mbërritur Babagyshi i Vitit të Ri. Babagyshi në fjalë është babai i Arbanës dhe gjyshi i Jonit, pra babagysh Demiri! "Gëzuar Krishtlindjen nga unë dhe babi im babagysh", shkroi moderatorja e njohur nën foton e shpërndarë në "Instagram". Atmosferë vërtetë zemërngrohëse në shtëpinë e moderatorës këto ditë.





# 10 keshilla per një trup sa më të bukur

**Këshilla e parë:** Ujë, pini sa të keni mundësi gjatë ditës. Rekomandimi ditor për ujë është 8-10 gota në ditë. Uji është shumë i rëndësishëm sepse ndihmon tretjen e ushqimit, shpejton metabolizmin e trupit, e shpërblan organizmin gjatë ditës dhe në të njëjtën kohë është shumë i rëndësishëm për funksionimin e kyçeve të trupit, si gjunjët dhe brylat. Një e mirë tjetër e ujit është që të bën të ndjehesh i ngopur, pa ngrënë shumë kalori. Gjithashtu organizmi funksionon në mënyrë optimale kur nuk është i dehidratuar. Për çdo 2% dehidratim, muskujt humbin 14% fuqi.

**Këshilla e dytë:** Konsumoni ushqim me cilësi. Trupi është si makinë, dhe si çdo makinë ka nevojë për karburant për të funksionuar mirë, bile karburant me cilësi. Mbani mend, makinën mund ta ndërroini sa herë që të doni por trupin e keni deri sa të vdisni, kështu që trajtoni mirë. Zakonisht, 5-6 porcione të vogla ushqimi është më mirë sesa tre porcione: mëngjes, drekë dhe darkë që ne jemi mësuar të hamë. Porcionet më të vogla treten më shpejt në sistemin e tretjes dhe japin më shumë energji trupit. Për ato që nuk kanë mundësi për proteinë pluhur, qumështi pluhur, është pothuajse njësoj sepse ka shumë aminoacide të rëndësishme për trupin dhe shëndetin. Kini kujdes, këto porcione duhet të përmbajnë me tepër proteinë dhe më pak karbohidrate. Zakonisht 2 gram proteinë për çdo kilogram peshë trupi është më se e mjaftueshme. Me pak fjalë, një porcion ushqimi duhet të ketë një njësi proteinë dhe një njësi karbohidratesh. Një mënyrë tjetër për të peshuar është me masën e dorës. Kjo është më e thjeshtë dhe e arsyeshme. Për shembull: masa e dorës grusht është një njësi karbohidrate, ajo është

zakonisht një patate apo një portokall (nga që kemi shumë këtu në Florida), ndërsa masa e një proteine është sa dora e hapur pa matur gishtat. Kjo është zakonisht masa e një berxolle.

**Këshilla e tretë:** Ky hap është pak i çuditshëm për shumë njerëz megjithatë është shumë efikas. Pas drekës dhe darkës, hani një lugë vaj ulliri. Vaji i ullirit quhet ndryshe yndyrë e mirë (polyunsaturated), dhe ndihmon në heqjen e dhjamit nga trupi. Përveç kësaj vaji i ullirit i jep trupit energjinë e duhur për të kursyer djegjen e proteinave për energji.

**Këshilla e katërt:** Suplemente ushqimore. Nuk ka nevojë të përdorësh të tilla suplemente, por vetëm nëse nuk keni kohë për të gatuar apo jeni i lodhur duke përtypur 6 herë në ditë. Përdorini me kursim.

**Këshilla e pestë:** Suplemente vitaminash dhe minerale. Një tabletë Multivitaminë/Multimineral zakonisht mjafton për t'ju dhënë sasinë e caktuar të vitaminave. Ato zakonisht janë të parrezikshme për trupin.

**Këshilla e gjashtë:** Bëhëni



zakon stërvitjen. Të paktën tre herë në javë në mëngjes ikni në palestër dhe vraponi ose bëni biçikletë për 45 minuta, pastaj pas pune rreth orës gjashtë apo shtatë bëni stërvitje me peshë për rreth 45 minuta. Është vërtetuar që diçka duhet të përsëritet 21 herë para se të bëhet zakon. Pra, të paktën 21 herë shtyjeni veten për të shkuar në palestër.

**Këshilla e shtatë:** Stërvitje Kardiovaskulare. Këtu është fjala për vrap, not,

biçikletë, patina, Stairmaster, Crosstrainer etj. Çdo aktivitet që e ngrë nivelin e rrahjeve të zemrës në zonën e stërvitjes për një kohë të caktuar, forcon zemrën. Rreth 20-45 minuta, tre deri në katër herë në javë është e mjaftueshme për të humbur peshën në mënyrë graduale dhe të shëndetshme. Pulsu duhet të jetë diçka si 120-150 rrahje për minutë, megjithatë ka një formulë të caktuar për këtë.

**Këshilla e tetë:** Stërvitje



force. Këtu bëhet fjalë për stërvitjen me peshë. Si për meshkuj dhe për femra stërvitja me peshë nuk ka zëvendësim. Është mënyrë më e mirë, për të shtuar masë muskulore, që ndihmon në djegjen më të shpejtë të kalorive dhe ndihmon në zbuturimin e formave të trupit. Tre deri në katër herë në javë, 30 minuta deri në një orë është e mjaftueshme për të arritur këtë synim.

**Këshilla e nëntë:** Shplodhu-

ni. Nuk mund të theksohet në mënyrë të mjaftueshme. Trupi ka nevojë për çlodhje. Kur bëni stërvitje organizmi futet në një fazë stresi fizik dhe vetëm s'lodhja e ndihmon për t'u rikuperuar. Duhet të paktën shtatë deri në tetë orë gjumë, dhe gjysmë ore gjumë pasdite është mjaftueshme për të çlodhur organizmin, megjithëse ka shumë faktorë që e ndikojnë gjumin, si psh: cilësia e gjumit, volumi i stresit mbi trupin, dhe ndryshime gjenetike. Shumë njerëz çlodhen me 5 apo 6 orë gjumë, shumë të tjerë kanë nevojë 8 apo 9. Shikoni me kujdes dhe studioni trupin tuaj. Nuk ka tregues më të saktë sesa vetë trupi.

**Këshilla e dhjetë:** Stërvituni me një shok. Kjo mund të jetë këshilla më e rëndësishme që ju jepet. Ndjenimi gjithmonë më rehatshëm kur kemi dikë me vete. Ndaloni dhe mendoni për një minutë! Kur niseni për të blerë diçka në dyqan, gjithmonë merrni një shok me vete apo jo, për të ndihmuar dhe për të kaluar atë fazën e paretatshme të zgjedhjes së rrobave. Një arsye, për të pasur gjithmonë një shok, është se sa herë që ndjeheni të lodhur apo të stresuar, dhe s'e keni mendjen për stërvitje e dini se shoku juaj po ju pret në palestër apo në park për tu stërvitur. Një shok gjithashtu është i rëndësishëm për t'ju shtyrë sa më tepër për të vrapuar atë kilometrin e fundit apo për të ngritur ato dy përsëritjet e fundit të peshave. Ashtu si në jetë, çdo njeri ka nevojë për një partner për të përballuar dhimbjet e jetës. Ashtu dhe çdo njeri ka nevojë për një partner për të përballuar dhimbjet e muskujve.



# BULEVARDI

## POLITIK

*Në merrni seriozisht!*

### Elisa e ka marrë seriozisht ftesën e ministres për të lexuar libra

Pak kohë më parë ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro bëri një ftesë gati të pazakontë për të rinjtë kryesisht për të lexuar libra. Që të ftoh të rinjtë për të lexuar libra nuk ka asgjë të keqe, aq më shumë kur kjo ftesë vjen nga ministrja e Kulturës, por ajo që e bënte të pazakontë këtë ftesë ishte mënyra se si Kumbaro kërkoi të provokojë dhe të tërheqë vëmendjen e lexuesve dhe miqve të librit. E duket se një nga ata që e ka marrë seriozisht ftesën e saj për të lexuar është edhe deputetja Elisa Spiropali. Siç shihet nga fotoja, Spiropali ka marrë jo një, por plot 7 libra. Nuk dihet nëse librat i ka marrë t'i lexojë vetë apo do t'i shpërndajë për të tjerët, por e sigurt është që ajo është angazhuar në lëvizjen kombëtare për lexim.



### Spartak Braho nuk e harron LSI-në, takohet me ish- kolegët

Spartak Braho është një nga deputetët më të vjetër të Kuvendit dhe gjatë viteve ka milituar në dy forca politike, fillimisht në Partinë Socialiste dhe më pas për shumë vite si pjesë e Lëvizjes Socialiste për Integritim. Por pavarësisht se ka qenë një nga themeluesit e LSI-së, ai vitet e fundit vendosi që të shkeputet prej saj për t'u kthyer sërish në Partinë Socialiste, prej nga dhe u shkëput në vitin 2003 për të krijuar LSI-në bashkë me shumë figura të tjera socialiste. Por ndonëse tashmë ai gjendet në kahe të kundërta politike me LSI-në, duket se nuk i ka shkeputur marrëdhëniet me shumë prej ish-kolegëve të tij të tij në LSI, me të cilët ndahu shumë beteja politike. Fotoja që ju sjellim është bërë gjatë seancës së fundit plenare, të premtën e shkuar në oborrin e Kuvendit të Shqipërisë, ku Braho është i rrethuar nga ish-kolegët e tij të partisë, Lefter Koka, Vangjel Tavo, Nasip Naço dhe Agron Çela. E duket se as ata nuk e kanë harruar miqësinë me Brahon, pasi në foto kanë dalë shumë të qeshur.



### Bledi Çuçi nga shapkat me gisht, te këmishat me lule



Bledi Çuçi është një nga politikanët e rinj socialistë, i cili është përpjekur që falë punës si teknikien të hedhë hapa të suksesshme në Partinë Socialiste, duke u zgjedhur edhe ministër. Por përveç anës së tij profesionale, Çuçi është një nga politikanët që njihet edhe për tipin e tij moskokëçarës kur vjen puna te veshja. Të gjithë e mbajnë mend Çuçin kur disa vite më parë vinte në Kuvend si ekspert i PS-së për reformën zgjedhore, me pantallona të tejdukshme linoje dhe shapka me gisht. Por jo vetëm atëherë kur ishte thjesht një teknikien, por edhe sot që është deputet, Çuçi me veshjen e tij lë të kuptohet se tendencat e modës, por edhe kodi i veshjes në një institucion si Kuvendi nuk janë fare interesi i tij. Këtë e tregon edhe kjo foto, ku Çuçi na shfaqet me një këmishë me lule dhe komplet shpërfillës për të mbajtur kollare apo kostum.



### Sherri në emisionin 'live', deputeti i vërsulet analistit me grushte e shkop

S'herr gjatë transmetimit 'live' të një emisioni në një kanal televiziv në Ukrainë. Përplasja fizike ndodhi kur po diskutohesh me Rusinë dhe ndërhyrjet e saj në Ukrainë dhe emisioni po transmetohej 'live' në "TV News One". "Sputnik" raporton se deputeti ukrainas Igor Mosiyçuk është konfliktuar me analistin dhe ekspertin e shkencave politike, Aleksandr Semçenko. Mosiyçuk akuzoi analistin Semçenko se paguhet nga Ilderi i Çeçenisë, Ramzan Kadirov për të bërë propagandë për Rusinë. Semçenko reagoi duke e quajtur deputetin të sëmurë mendor, çka bëri që ky i fundit ta sulmonte analistin.

ARTISTI

# Matis, ballë telajos gjer në ditën e fundit

Nga Luan Rama

*Emigrantja ruse Lydia, modelja që nuk iu nda deri sa mbylli sytë*

**E**dhe pse në moshë të thyer dhe shumë i sëmurë, duke se plakur Matis (Henri Matisse) nuk donte të hiqte dorë nga piktura dhe peneli i tij. Atje në Nice, ku ishte vendosur prej vitesh dhe ku punonte së fundi në një dhomë hoteli, ai donte ta çonte deri në fund aventurën e tij piktorale, edhe pse i duhej të vinte një korse hekuri në trup për të ndenjur ulur ballë kavaletit. Me të mund të qëndronte ulur veçse një orë dhe kjo ishte një sfidë e jashtëzakonshme. Por siç dihet, dashuria për artin i mund të gjitha dhimbjet, barrierat, sfidat. Edhe ai, ashtu si dikur piktori Claude Monet, që vitet e fundit në tablotë e mëdha me nenyfarë i hidhte ngjyrat me shumë me ndjesinë e mpiksjes së tyre në paletë sesa me optikën natyrale të syve, ashtu dhe Matisse hidhte linjat, ngjyrat në atë mjegull që dhe atë kishte nisur ta rrethonte. Mplakja dhe pafuqishmëria, jo rrallë i kujtonte atë udhëtim të dikurshëm kur Renuar ishte ende gjallë, me gruan e vdekur dhe kur ai ende merrte frymë me pikturën. Kishte gjithnjë dëshirë ta takonte plakun e mirë dhe gjenin e pikturës në atelierin e tij. Dhe ai kujtonte fytyrën e thatë të plakut të mirë, që plot dhimbje ulej të pikturonte. "Dhimbja kalon, - i kishte thënë Renuar, - por e bukur që krijohet, mbetet"! Kjo shprehje i kishte mbetur në mendje. "Nga fundi i Luftës së Parë Botërore, - kujtonte Matisse - ndodhesha në jug të Francës. Renoir ishte shumë i lodhur dhe meqë e adhuroja shumë shkova ta takoja në shtëpinë e tij në Cagnes. Më priti me kënaqësi dhe me këtë rast i tregova disa punime që të dija mendimin e tij. Ai i vështrroi me një pamje jo të kënaqur dhe pastaj më tha: Në të vërtetë nuk më pëlqen ajo që krijoni. Parapëlqej të të them se nuk je një piktor i mirë, madje mund t'ju them se jeni një piktor i keq. Por një diçka më bën përshtypje: kur ju e vendosni ngjyrën e zezë në tablo, ajo është në vendin e vet. Gjithë jetën kam menduar se s'mund ta përdorim atë pa thyer unitetin kromatik të sipërfaqes. Është një ngjyrë që e kam përfunduar nga paleta ime. Ndërsa ju, duke përdorur një lloj fjalori të shumëngjyreshëm, arrini ta fusni të zezën dhe ajo ngjyrë qëndron. Pra, pavarësisht asaj çka ndjej, ju me siguri jeni një piktor..."

Kjo thënie i kishte mbetur në mendje piktorit të ri edhe pse në atë kohë, në fillimin e shekullit, në sajë dhe të publicitetit të Gertrude Stein e cila nuk gabonte në shijet e saj mbi modernitetin, ai dhe Picasso, u bënë yjet e rinj të pikturës botërore. Shumë kohë do të kalo-



nin. Njihet konkurrenca e famshme mes tij dhe Picasso-s... pastaj miqësia e tyre. Dihet gjithashtu karriera e famshme e tij në tregun amerikan, xhelozia e piktorëve të tjerë rreth suksesit të tij kur koleksionistë të shumtë kërkonin tablotë e tij, apo historia dhe lidhja e gjatë me koleksionistin amerikan Barnes apo në veçanti me koleksionistin rus Chtchoukin, ("Nympe et Satyre", "Bonheur de vivre", etj.), i cili krijoi një nga koleksionet e bukura të botës, koleksion të cilin revolucionarët e Leninist të ardhur në pushtet ia morën dhe ai përfundoi në një rrënim të plotë bashkë me fabrikat e tij të tekstilit. Matisi kujtonte gjithnjë atë ditë kur kolegu i tij Braque i kishte shuar në atelier për të parë tablotë e Renuar dhe Gogen që Matis kishte blerë. Por mes tablove të tij ai për asnjë çast nuk i hodhi sytë dhe nuk foli asnjë fjalë. Kjo atë e plagosi dhe ai gjithnjë vuante në heshtje, siç ishin dhe sulmet që i bënin partizanët e Pikasos...

Jeta e Matisit është një libër me vete, një roman dramatik, me

jat e tij të njohura, teknikën dhe sipërfaqet e ngjyrosura të tij, kohë kur gjatë periudhës së fovizmit, ai i kishte shumë rëndësi sipërfaqeve të mëdha me ngjyrë, dhe kjo nën influencën e Gogen dhe Van Gog.

Që i ri shkante në Louvre dhe kopjonte mjeshtrit e mëdhenj për të gjetur perfeksionin e pikturës. "Jam përpjekur ta zhvilloj personalitetin tim veçanërisht përmes instinktit që kam. Më kujtohet kur para Pont des Arts, duke parë nga Pont Neuf, mjeshtri im Gustave Moreau, papritur më tha: "Atëherë çfarë kërkon në pikturën tënde? - Kërkoj të jap atë pikturë që mjeshtrit nuk e kanë dhënë, p.sh. kjo pamje para nesh, këtë bukuri që mjeshtrit nuk e kanë fiksuar. - Kush ju tha se atë nuk e kanë parë dhe të mos donin ta pikturonin?... Kështu filloi shkëputja ime nga mënyrat e vjetra të pikturimit që megjithatë nuk i kam harruar. Në vend që të vazhdoja të isha një flutur diletante që bridhte nga Rembrandt tek Corot, nga Veronese tek David, nga Heim tek Chardin, unë e ndjeva veten një puntor modest duke patur si mbështetje veç pavarësinë dhe singleritetin tim..."

## SENSUALITETI SUBLIM

Po të shohësh nimfat dhe nudot e para të Matisse, e ndjen menjëherë sensualitetin e tij të veçantë, edhe pse artisti ishte fjalë-pakë, timid, shpesh i rëndë me femrat, por kur ato pozonin para tij, në heshtje ai shikonte çdo detaj të trupit femëror. Jo rrallë modelet i zgjonin dëshirën për të qenë akoma më pranë tyre, siç tregonte në kujtimet e saj dhe një modele me origjinë ruse, arie Vassiliev që disa kohë jetoi në një dhomë afër tij. Kjo kishte ndodhur në vitin 1909: "Atë mëngjes isha duke fjetur kur Matisi, i cili kishte zbritur nga dhoma fqinjë, i ra derës. E veshur me një kimono i hapa derën dhe ai më zgjati vizatimet: "Të kam sjellë ilustrimet". - "Prit të vishem", i thashë. Shkova të vishem por ai qëndron-



te duke parë ende nga shtrati që ishte ende i ngrohtë. Kaq duhej dhe në përfundim në atë shtrat..." Një ditë e përafërt i kishte ndodhur me modelen tjetër Olga Meerson, të cilës i kishte bërë disa portrete. Përsëri kishte hyrë në dhomën e saj, por më vonë i kishte kërkuar falje, pa tentuar ti afrohet sërish hireve të saj. Kur ajo ishte larguar përfundimisht nga ai, më vonë Matisi i kishte falur paletën e tij të ngjyrave të cilën ajo e ruajt gjatë gjithë jetës. E adhuronte mjeshtrin e madh.

Gruaja e tij ishte disi autoritare dhe nuk i afrohet femrat në shtëpi, madje dhe modelet i vëzhgonte nga afër. Kur Matisi shkoi në Tanger për të ndjekur shembullin e orientalistëve francezë siç ishte dhe Delacroix para tij, kërkoj të krijonte portrete dhe nudo, por Amelie, gruaja e tij, ishte ngado. I zoti i hotelit i gjeti një vajzë të quajtur Zorah që t'i pozonte si model. Ajo vinte e fshehur nga njerëzit që mos ta shikonte askush. "Po ta shikonte vëllai i saj se po pozonte, ai mund ta vriste në vend" - kujtonte Matis. Ishin vitet 1911-1913. Një ditë, diku në një tarracë, shikoi një grua të shtrirë, një mulatë të pa mbuluar me shami. Dhe filloi ta pikturonte. Madje në këtë rast, bashkë me gruan e tij shkollon bashkë në ndonjë nga bordellet e qytetit ku vetëm duke pasur gruan, ai mund të lihej të pikturonte dhe sigurisht duke paguar. Dhe gratë atje habiteshin se si ky evropian vinte atje bashkë me gruan e tij. Nudo e tij nga Magrebi janë vërtet të mrekullueshme, ashtu dhe peizazhet e tij plot kolorit.

Në vitet '30-'40 janë interesante tablotë e tij "nature morte" ku ndihen forca e ngjyrës, pasi për Matisin, influenca e ngjyrave tek njërë-tjetra ishte themelore dhe përbënte thelbin e punës së vet me ngjyrat. "Ngjyrat, - shkruante ai në një libër "Mbi pikturën", - nuk mund ta kenë fuqinë dhe elokuencën e tyre në gjendje të pastër, ku shkëlqimi dhe pastërtia e tyre nuk është cenuar". Apolineri që kishte qenë një nga miqtë dhe mbrojtësit e tij, pikërisht atëherë shkruante se "Elokuenca





e veprave të Matisit vjen para së gjithash nga kombinimi i ngjyrave. Është kjo që përbën artin e piktorit... të vesh në rregull kaosin: ja krijimi!"

#### LYDIA, MODELJA

Më 15 korrik 1939, pas njohjes së tyre të parë, emigrantja ruse që jetonte ato kohë në periferi të Parisit i dërgonte Matisit një tufë me lule për ta falënderuar. Ajo quhej Lydian dhe lulet e saj ishin lule margarite të bardha. Në tufën e luleve, nën një copë letër ajo kishte shkruar: "Lule për Shën Henrin". Mjeshtri i ra në sy kjo gjë dhe kishte dëshirë ta shikonte sa më parë modelen e re. Në kujtimet e saj për atë kohë Lydia Delectorskaja do të shkruante: "Pikërisht atë çast u vendos bashkëpunimi ynë për të ardhmen. A do të më merrte me vete apo jo? Atëherë s'kisha ku të kapesha dhe të gjeja mbështetje. E dija se të tjerët do të thoshin: "Kjo vajzë e bukur shkoi pas këtij plaku të pasur". Por unë s'kisha nevojë të mbroja nderin tim. Ai më tha: 'Ti je e re, ke jetën përpara dhe ke shumë rrugë për të bërë!'. - Rrugë për ku? - i thashë unë. Dhe ai u përgjigj nëpër dhëmbë: Ah, vajzë e gjorë!... Ai e kuptoi se isha diçka e virgjër e që mund të bënte ç'të donte me mua..."

Dhe mjeshtri i pikturoi menjëherë ato lule të bardha të modeles së re. Një lidhje e bukur, shpirti nisi mes të dyve. Ai e vizatonte si modelen e tij ulur në karrige apo shtrirë në divan, nudo, ashtu siç kishte vizatuar dikur dhe të tjerat. Kur gruaja e mori vesh se Lydia jetonte atje, ajo nisi të vinte në shtëpinë dhe atelieron ku punonte Matisi dhe demonstroi xhelozinë e saj. Po kështu dhe femijët e Matisit. Askush nuk i fliste Lydias, edhe pse ajo ishte aty, para tyre, gjithnjë pranë mjeshtrit. Dhe ata bënin sikur nuk e shikonin dhe sikur ajo nuk ekzistonte aty. Ç'komedi! Kjo gjë e trishtoi Lydian dhe ajo tentoi të largohej për një kohë. Por Matisi i kërkoi të qëndronte me të dhe nisi ta merrte kudo me vete. Ishin të lumtur. Mjeshtri punonte, krijonte dhe ajo kujdesesh për gjithçka: pozonte, rregullonte shtëpinë, gatante dhe



e shihte atë në dritë të syrit. Ishte ajo që kujdesej dhe për ilaçet e tij. Vitet kalonin dhe një ditë mjeshtri thirri një modele të re. Kishte nevojë për individualitetet e forma të reja. Franca ishte pushtuar nga Gjermania naziste dhe modelja e re ishte vajza e një të varfëri dhe duhej ta ndihmonte me para, ti siguronte familjes së saj triska ushqimi. Pastaj e mori si modele në atelien dhe nisi ta pikturonte. Në shtëpinë atelier tashmë ishin ai, Lydia dhe ajo modele me flokë të gjata, të dendura, me një qafë të bukur që i zbulonte akoma më mirë hiret e saj. Dhe Lydia e donte atë, mjaftonte që mjeshtri të ishte i lumtur. Ishte viti 1942. Kohë me pas, një tjetër modele do të vinte në atelier, një holandeze e ikur nga Amsterdam, Annelis Helek, e cila u kishte shpëtuar bombardimeve dhe luftës, duke zbrakuar në Paris.

Në vitet '40-'50, Matisi ishte bërë një nga ikonat e artit francez e botëror. Një gazetarë e njohur amerikane shkoi në jug të Francës, në Nice, ta intervistonte dhe të shkruante rreth tij. Atë kohë po punonte për tablonë e madhe "Vallja" (La Danse) për muzeun që donte të krijonte kole-

ksionistit i madh Barnes me tablo edhe të Sezan, Renoir, Seurat, Vuillard, Chagall e shumë të tjerë që ai i blinte sa herë vinte në Paris. Gjatë bisedës, duke parë tablotë gazetaria ishte shprehur: "Është diçka që nuk e kam parë kurrë, diçka e thjeshtë dhe e kalkular". Sapo e dëgjoi, Matisi i ishte kthyer menjëherë: "Ah, e kalkular... kjo fjalë nuk shkoi për veprën time. Kam punuar 40 vjet pa ndërprerje, kam bërë studime e sprova. Kjo që kam krijuar tani ka dalë nga zemra. Gjithë piktura ime krijohet në këtë mënyrë. Unë i ndje!"

Në periudhën e fundit të jetës së tij, Matisi priste letra të ngjyera me bojë dhe krijonte variacione kromatike. Po kështu punoi në qeramikë, si Picasso, madje i ftuar në atelien "Madura" të Picasos, ku ishte dhe bashkëpunëtori i tyre Abedin Dino me origjinë shqiptare. Një kohë u mor me vizatsh e një kishë të vogël tepër të dashur të tij në Vence, për çka një kritik arti do ta cilësonte si një "rrobaqepës i dritës" për kompozimet e tij. Ai punonte kudo ditë, dhe kjo ishte motoja e gjithë krijimtarisë së tij: "Është epamundur të harroj se jam Matisi, se unë jam skllav i kësaj tavoline. Nganjëherë them: sa ditë

e bukur për të bërë një shtëpitë të vogël e të shkoj jo larg që këndej për të takuar Rouault apo Bonnard. Por atëherë mendoj për ngjyrën që thahet në telajo dhe nëse e lë tablonë në mes hidhërohem dhe e ndjej shpirtin e vvarë. Unë nuk fle pa e përgatitur punën për nesër..."

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, bashkë me Pikason dhe Chagall, Matisi u bë referenca më e fuqishme e piktorëve francezë. Një prodhimtari e jashtëzakonshme që kaloi nga piktura e vajit tek ajo dekorative dhe artet e tjera. Por padyshim, puna themelore e tij ishte ajo me ngjyrën. "Do doja t'u thosha të tjerëve se nuk i duhet afruar ngjyrës sikur të shkosh në një mull, pasi më parë duhet të bësh një përgatitje të madhe dhe të denjë për profesionin... duhet të kesh dhuntinë e ngjyrës ashtu si një këngëtar që duhet të ketë dhuntinë e zërit. Pa këtë dhunti s'mund të shkojmë askund...". E sigurisht, në gjithçka të mrekullueshme që na dhuroi ky mjeshtër i madh, në themel ishte puna e jashtëzakonshme e tij, kërkimi i etshëm, kërkimi në magjinë e ngjyrave që siç shkruante poeti Pierre Reverdy në një artikull të tij "Matisi në dritë dhe në lumturi", "ai ishte një shpikës i pashtrësishëm i formave dhe ngjyrave...". Po, në net të gjata, ditën, në muaj, vite, dekada e gjer në ditën e fundit të jetës së tij, ai do të vazhonte të krijonte. A nuk thoshte Matis se "do të doja të jetoja si një murg në një qeli, veç të kisha diçka për të pikturuar në mënyrë që të mos më shqetësonin të tjerët"? Vizatimi i tij i fundit ishte portreti i modeles së tij besnike, Lydias. Ajo e pa në duart e mjeshtrit, i cili i tha: "Nuk është keq, apo jo?... Mjeshtri kishte qeshur. Ishte puna e tij e fundit.

Është e habitshme dita kur u varros mjeshtri 84 vjeçar në varrezat lart në një kodrinë të Nisës. Atë ditë tepër të vrenjitur, kur kortezhi i ngjitej kodrinës nën atë qiell të errët, papritmas errësira filloi të çahet dhe të shfaqej një dritë e madhërishe që i mrekulloi të gjithë ata njerëz që ngrinin kokat lart drejt asaj

mrekullie, sikur hyjnitë ta dimin se po vdiste një nga pinjollët e tyre, sikur ajo dritë nën kubellë e qiellit, të ishte një tablo qiellore si ato të Matis, nën të cilën mbulohej gjeniu i madh...

Tani që po shkruaj këto radhë për Matis, kujtoj bisedat me shumë piktorë shqiptarë adhurues të tij dhe së pari Sadik Kacelin, aq i pasionuar pas tablove të tij që kishte parë në një revistë të mëdhenj francezë, dhe së pari adresën e Matisit, i cili e kishte mrekulluar. Kështu, me t'i rënë në dorë adresa, ai u ul dhe i shkroi. Ishte letra e një djaloshi shqiptar, nga një cep i Ballkanit dhe një bote orientale që po zgjohej duke vështruar nga Perëndimi, një letër e shkruar plot sinqeritet e dashuri për artin. Sigurisht, kjo letër që mundi të bjerë në duart e Matisse, e preku atë dhe ai mori mundimin t'i ktheje përgjigje këtij djaloshi të panjohur nga një vend fare i vogël dhe gati i panjohur për të. Dora e mjeshtrit shkruante: "I dashur zotëri. Në përgjigje të letrës suaj ju këshilloj se do të ishte mirë t'i adresoheshit zotit Andre Lhot, në adresën 38 bis, Ruega Bouland, në Paris, i cili drejton një akademi të rëndësishme dhe të cilit po i dërgoj gjithashtu letrën tuaj. Pranoni zotëri shprehjen e ndjenjave të mia të veçanta për ju... Henri Matisse".

Sigurisht në Akademinë e Arteve të Parisit, dy hapa larg muzeut të Luvrut, Kaceli u njoh me piktorin më të shquar të botës e veçanërisht me Rilindjen italiane, por Matisi do të mbetej për të një nga më të preferuarit.

Matisi mbeti padyshim një gjeni i pikturës botërore, ashtu si bashkëkohësit e vet Sezan, Pikaso, Chagall e të tjerë. Jeta e tij ishte një rrugëtim i gjatë e i lodhshëm në territoriet e pafunda të ngjyrave dhe të formave. Eksperienca e tij në këtë drejtim do të ishte një udhërrëfim për gjeneratat e piktorëve pas tij.

Opinion

i Ditës

# Euro nga ballkoni i katit të parë

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... tradicionale (gazeta, televizione, etj.) dhe të rrjetit (portalet, të ashtuquajtura "media online") kanë raportuar këto ditë nivele shumë të ulta të këmbimit të monedhës evropiane me lekun tonë. Po. Është e vërtetë. Janë nivele të ultra rekord. Euro këmbëhet më ulët se edhe 10 vjet më parë, me vetëm 123 lekë. Më 20 dhjetor madje ra edhe poshtë dyshemesë 123 lekë. Mirëpo, prej këtej, të thuash se euro në tregun tonë është "në pikiatë" apo "në rënie të lirë", me nënkuptimin se po ndodh kiameti, ka në mes një det të tërë. Po pse? Sepse rënia e lirë apo pikiatë nënkuptojnë një humbje që përshpejtohet me kalimin e kohës. E tillë ka qenë rënia e euros në gjashtë muajt e parë të këtij viti (janar-qershor 2018), kur monedha e Bashkimit Evropian humbi 9 për qind të vlerës së saj nga 136 lekë në 124 lekë. Në këtë periudhë eksportuesit ishin shumë të shqetësuar, madje në ditët e para të qershorit, filluan të shqetësoheshin edhe qytetarët. Në duart e shumëkujt eurot nisën të digjnin dhe nisi pasiguria: "a duhet t'i mbaj paratë në euro, apo t'i kthej se mos humb keq?". Banka jonë qendrore nuk e la një pasiguri të tillë të kthehej në ankth. Ndërhyri në 6 qershor, duke blerë me miliona euro. Ndërkohë, një dukuri e tillë nuk ndodhi këta gjashtë muajt e dytë korrik-dhjetor 2018. Për shkak të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë, u qetësuan eksportuesit, u qetësuan vepërimtarët e këmbimit. U qetësuan edhe qytetarët zotërues shumash në euro. Si rezultat, euro qëndroi në nivele 125-124 euro për katër muaj rresht korrik-tetor 2018. Gjeti një ekuilibër të ri me lekun, në nivel 124 lekë. Në dy muajt e fundit është ulur me afro 1 për qind (ka rënë me një lek) në 123 lekë. Një ulje krejtësisht e kuptueshme nga



fluksi i eurove prej emigrantëve që me dhjetëra mijëra vijnë në dhjetor (si në çdo vit) që të festojnë festat e fundvitit pranë familjeve të tyre në Shqipëri. Dhe shpenzojnë ose sjellin me dhjetëra milionë euro në tregun tonë. Prandaj dhe Milton Friedman (çmimi Nobel për ekonominë në vitin 1976), në studimet e tij për historinë monetare (të parasë), uljen e beftë të një monedhe në këmbimin në treg e krahasonte me rënien nga kati i dhjetë i një pallati, për pasojat që mund të ketë për një ekonomi, ndërsa rënien graduale, edhe pse në nivele rekord të

zbritjes, me rënien nga ballkoni i katit të parë. Kjo është edhe gjendja me këmbimin e euros me 123 lekë sot tek ne. Me gjithë një rritje anemike të ekonomisë sonë (edhe duke qenë 4 për qind për këtë vit, kjo shtesë nuk krijon shumë vende të reja pune), mbajtja e normës së interesit të parasë në nivele shumë të ulta (vetëm 1 për qind) nga banka jonë qendrore, i ka mundësuar kreditë për sektorin privat të shtohet me 4.9 për qind dhe 4.5 për qind, përkatësisht gjatë tremujorit të tretë (korrik-shtator 2018) dhe dy muajve të parë të tremujorit të katërt (tetor-nëntor 2018). Edhe pse

shtimjo spektakolar, ai është premtues për vitin e ardhshëm 2019. Norma e ulët e interesit të parasë ka ndihmuar, gjithashtu, edhe ristrukturimin e kredive me probleme, që frenojnë huadhënien. Stoku i tyre në nivelin tërësor të kredive ka zbritur prapë në 12.7 për qind në muajin nëntor 2018, duke i dhënë një impuls tjetër pozitiv bankave për të rritur kreditë për qytetarët dhe bizneset për vitin që vjen. Do të ndodhë vërtet që kredia, motori kryesor i rritjes për një ekonomi sot, të shtohet ndjeshëm vitin që vjen? E urojmë me gjithë zemër, me gjithë tensionin politik

dhe klimën e protestave që do të çelë janari 2019. Vendi ka nevojë për siguri që ekonomia jonë kombëtare dhe interesi për xhepin e gjithsecilit prej nesh të përfitojë në më shumë kredi dhe vende të reja pune. Nëse nuk na prish shumë punë politika, gjasat janë të gjitha që kredia të rritet edhe 8-9 për qind për vitin e ardhshëm dhe euro të qëndrojë vetëm në ballkonin e katit të parë në këmbimin e saj me lekun, sipas shprehjes së Friedman. Euro nuk ka si bie në pikiatë dhe në rënie të lirë tek ne, me gjithë zellin dhe oreksin për lajme sensacionale të disa mediave pak të informuara ose jo-profesionale.



**BLUE TOOTH**

THASHETHEME  
MADE IN  
ALBANIA



ALBANIA THASHETHEME

te rejat nga jeta ipave

çdo të shtunë falas me



Dje në "Deutsche Welle"

# 2019, më shumë të djathtë në Parlamentin European

Nga Bernd Riegert

(vijon nga faqja 1)

... e populizmit të djathtë, konfliktet me Poloninë, Hungarinë dhe Rumaninë për mungesën e shtetit të së drejtës. A mund të bëhet më keq? Po, mund të bëhet, por jo domos.

Në maj 2019 do të zgjidhet një Parlament i ri European, i vetmi parlament supranacional i zgjedhur në mënyrë demokratike në botë. Pastaj në vjeshtë bëhet emërimi i personave për të gjitha postet kryesore europiane, që nga presidenti i Komisionit deri tek presidenti i Bankës Europiane. Nëpërmjet kësaj nuk është se zgjidhen krizat, por krijohet mundësia për një fillim të ri.

## MË SHUMË RADIKALË NË PARLAMENT

Nëse u beson studiuesve të zgjedhjeve, atëherë numri i radikalëve të djathtë dhe populistëve deputetë në Parlamentin European do të rritet nga dhjetë që është sot në 20 për qind, pra do të dyfishohet. Fraksioni më i fortë nuk do të bëhen kundërshtarët e BE, por ata do të marrin më shumë ndikim dhe mund të zvarrisin integrimin dhe reformat. Rezultati i zgjedhjeve do të pasqyrojë pakënaqësinë në rritje të popullsisë ndaj BE. Mendimi se anëtarësia në BE nuk sjell asgjë, ka pak të bëjë me faktet, por populistët dinë ta ndezin këtë ndjenjë, duke filluar që nga populistët e Le Penit në Francë, tek Salvini në Itali dhe Gauland në Gjermani. Të mbytur me emigrantë, të varur nga globalizimi? Këtyj imazhi të errët dhe të gabuar duhet t'i kundërvihen përkrahësit e BE-së. Kursit nacional me "vendi im i pari", i duhet kundërvënë "Europa është për mua e rëndësishme" për mirëqenien dhe pagën.

## BE DO TË ZVOGËLOHET

Me largimin e britanikëve, Bashkimi European zvogëlohet për here të parë në histori. Kjo do të shkaktojë rënien e fuqisë, të paktën në politikën e jashtme dhe të sigurisë. Pa forcën ushtarake të Britanisë së Madhe, BE nuk ka shumë forcë në botë. Nga pikëpamja ekonomike, europianët mund t'ia dalin mbanë edhe pa britanikët. Dëmi është më i madh për britanikët vetë. Që Brexitit do të ketë fillimisht pasojë negative e ka pranuar edhe vetë qeveria. Për shkak të bllokadës totale në Dhomën e Ulët të Parlamentit, ekziston ende mundësia që Brexitit të shtyhet, gjë që mirë do ishte të ndodhte, pavarësisht se si.

Populistët e Italisë mbeten sfidë Mbas shkëputjes së Britanisë që paguan në BE, do bëhen më të rëndësishëm ato vende të tjera që po ashtu paguajnë si për shembull



Italia. Ata duhet të paguajnë më shumë në buxhetin e përbashkët, por pikërisht qeveria populiste në Itali mbetet një faktor sigurie për BE. Udhëheqësi i Legës radikale të djathtë, Matteo Salvini, është si ministër i Brendshëm, i pakënaqur. Ai kërkon të bëhet kryeministër dhe prandaj do të bëjë fushatë duke e kthyer Brukselin në kokë turku. Nëse Italia përfundon në recesion, për këtë është fajtor Komisioni i BE. Pak shpresë ekziston që grindja aktuale për buxhetin e 2019 ar-

riti të shuhej pak në dhjetor, me gjithë borxhet e mëdha italiane. Por buxhetet më të vështira për Italianë janë 2020 dhe 2021.

## BE-SË I DUHEN IMPULSE

Kundërpeshë për populistët kundërshtarë të BE është aktualisht presidenti francez Emmanuel Macron me partinë e tij pak të konsoliduar. Nëse Macron humbet vrullin mbas protestave të "Jelektivdhëve", atëherë BE humbet fuqinë shtyrëse. Prandaj vitin tjetër duhet të vijnë impulse

edhe nga Berlina. A do jetë mbase një koalicion i ri i konservatorëve dhe Të Gjelbërve, me një personel të ri udhëheqës, më entuziastë për Europën, apo vazhdon Merkel të ngatërrojë këmbët nëpër zgjidhjet e krizave?

Pavarësisht nga kriza e brendshme në BE, shtuhtë në politikën e jashtme do të shtohen: kërcënime nga Rusia, konkurrencë me Kinën për teknologjinë e lartë dhe ndikimi në Afrikë, si dhe bërësi i paparashikueshëm i 'deal'-eve në Shtëpinë e Bardhë. Kthesa në ekonominë dixhitale, që përdor inteligjencën artificiale dhe ekonomia e dobët do të kërkojë shumë fuqi më 2019 dhe shumë ide. Komisioni i BE mund të fitojë këtu pikë. Këtu Europa mund të tregojë se bashkë mund të arrihet më shumë se vetëm. Po, viti 2019 do të jetë viti i 30 në ndryshimet shoqërore në Europën Lindore dhe nuk do të jetë i lehtë, por asnjëherë nuk është e lehtë. BE është e mësuar me trajtimin e krizave. Kështu që ajo do e menaxhojë edhe tjetërin, pavarësisht cila do të jetë ajo.

Në maj 2019 do të zgjidhet një Parlament i ri European, i vetmi parlament supranacional i zgjedhur në mënyrë demokratike në botë. Pastaj në vjeshtë bëhet emërimi i personave për të gjitha postet kryesore europiane, që nga presidenti i Komisionit deri tek presidenti i Bankës Europiane. Nëpërmjet kësaj nuk është se zgjidhen krizat, por krijohet mundësia për një fillim të ri.

## HOROSKOPI

### DASHI

Nëse keni qenë duke pritur që gjërat të ngadalësohen pak, sot mund të jetë dita juaj me fat. Kjo fazë organizative është shansi juaj për t'u çliruar nga gjërat për të cilat nuk keni nevojë më.

### DEMI

Energjia juaj shoqërore është e paparashikueshme sot dhe lidhja me të tjerët mund të jetë e vështirë. Në biseda mund të ndiheni sikur jeni thellë në baltë, lëvizja përpara mund të jetë raskapitëse.

### BINJAKET

Mblidhni pak shpresë tani në fund të fundit, ka qaf shumë arsye për të menduar pozitivisht. Duhet të kuptoni se një fillim i ri po vjen. Kjo do t'ju japë besimin për të lëvizur në një drejtim të ri.

### GAFORJA

Jepini vëmendjen tuaj gjërave që me të vërtetë kanë rëndësi. Sot është një ditë e mrekullueshme për të filluar organizimin e një ribashkimi familjar, duke planifikuar një udhëtim në grup.

### LUANI

Jeni të bekuar me një kombinim të pakrahueshëm energjie dhe mprehtësie, kështu që mos hezitoni të veproni kur shihni diçka që mendoni se mund të ketë nevojë për vëmendjen tuaj. Nëse një mik vepron jashtë karakterit, pyeteni atë për këtë.

### VIRGJERESHA

Askush nuk do të mund të përfitojë më mirë sesa ju sot, prandaj mos kini frikë kur i afroheni çdo lloj negociate. Sa i përket dashurisë, jo gjithçka po ecën sipas parashikimeve.

### PESHORJA

Nëse zgjoheni i nervozuar, mund të kthehet në një nga ato ditë kur ndihet sikur të gjithë po përpiqen t'ju bëhen pengesë në rrugën tuaj. Për të shmangur këtë zhgënjim, ju duhet të filloni ditën sa më pozitivisht të jetë e mundur.

### AKREPI

Pa marrë parasysh se çfarë ndodh sot, mos harroni një gjë: ju mund të merrni gjithë kohën që ju nevojitet. Bëjeni çdo gjë me kujdes, me ngadalë dhe pa u nxituar fare. Kështu do të keni sukses.

### SHIGJETARI

Ndërsa vazhdoni në një rrugë pasiviteti, do të filloni të vini re gjërat që nuk keni pasur kohë t'i vini re më parë. Do të mësoni diçka të re për dikë që e njihni për një kohë të gjatë.

### BRICJAPI

Komunikimi me të tjerët do t'ju sjellë një gëzim të jashtëzakonshëm tani, kështu që është në interesin tuaj më të mirë për të nisur diskutimet sa herë dhe kudo që të mundeni.

### UJORI

Çdo person që ju shkakton stres duke ushtruar presion mbi ju tani është i ngjashëm me një mur me tullë, kështu që qëndroni drejt dhe mos u frikësoni. Kushtojni më shumë vëmendje dashurisë.

### PESHQIT

Nëse vërtet doni të bëni një ndryshim në komunitetin tuaj, ju keni një mundësi të madhe për të bërë këtë pikërisht sot. Ka gjëra të mira që po ndodhin në jetën tuaj, prandaj jeni i lumtur.

Kreu i Federatës Shqiptare të Futbollit skanon 360 ditët e vitit që po lëmë pas, mes sukseseve dhe problematikave

# Duka: Panuçit i kam bërë vërejtje, Partizani është me meritë në krye

Objektivi i presidentit, të hyjë në Ekzekutivin e UEFA-s



Jeton Selimi

**K**ategoria Superiore ka mbyllur aktivitetin e saj për vitin 2018, ndërka Kombëtarja Shqiptare ka njohur kundërshtarët me të cilët do të garojë për një vend në Euro 2020, duke filluar që nga muaji mars i vitit të ardhshëm. Për të bërë bilancin e një viti dhe për të diskutuar mbi gjithçka ndodhi në futbollin shqiptar gjatë 2018-ës, presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armando Duka dha një intervistë në "Supersport".

**Nëse do t'i vendosnim një notë vitit 2018, cila do të ishte sipas jush?**

Është e vështirë! Nuk kam qenë ndonjëherë mësues për të vendosur nota, por mund ta konsideroj si një hap pozitiv, krahasuar me vitet e mëparshme, jo vetëm nga rezultati, por nga gjithçka ka ofruar futbollit në jetën e shqiptarëve.

**Një nga temat më të debatuar në këtë periudhë, ishte statusi ligjor i disa anëtarëve të shoqatës. A është bërë diçka në këtë aspekt, që nga ajo ditë?**

Nuk ka pasur ndonjë arsye statutoare për t'u kontestuar ai detaj, pasi anëtarët e Federatës së Futbollit kanë qenë në vijimësi ata, pavarësisht mosrespektimit të ndonjë burokracie. Tashmë janë të regjistruara dhe është një kapitull i mbyllur, por që u bë i madh për shkak të ndërhyrjes së politikës.

**Zgjedhjet ju pëlqejnë, dhe këtë herë do të konkurroni për anëtar të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s...**

Mesa duket më pëlqejnë jo vetëm sfidat, por edhe shkurti, pasi edhe Kongresi i UEFA-s do të zhvillohet pikërisht në të njëjtën datë që fitova zgjedhjet në FSHF, një vit më parë. Jam kandidat jo si individ, por si dëshirë institucionale për të përfaqësuar Shqipërinë në këto nivele të larta të organizimave të futbollit. Sa më shumë të përfaqësuar të jemi në këto lloj organizimesh, më mirë do të jetë për ne. FSHF-ja ka shumë përfaqësues tashmë në nivele të ndryshme të UEFA-s, ndryshe nga dikur, që kishim vetëm një delegat. Kemi edhe Denis Bastarin, që tashmë është në administratën e UEFA-s, por edhe disa të tjerë që janë anëtarët të komitetit të ndryshme, si Edvin Libohova, Ilir Shulku, Artan Hajdari, etj. Edhe kandidimi im është në këtë lloj politike, për të qenë të përfaqësuar edhe më lart Shqipërinë.

**Flitet se mund të kandidoni në zgjedhjet lokale...**

Nuk e besoj se do të garoj në zgjedhjet politike.

**Bilanci i Panuçit është 14 ndeshje, 4 fitore, 2 barazime dhe 8 humbje, por sërish i dhjatë besim...**

Nuk jam penduar as që e



emërova dhe as që i konfirmova besimin. Unë të dy vendimet në lidhje me të, i konsideroj ende të drejta, duke pasur parasysh kohët kur janë marrë këto vendime. Kam besim se trajneri do të bëjë më mirë në të ardhmen.

**Sa mundësi ka që të ikë trajneri të Roma?**

E lexova si lajm, por nuk e di nëse ka vërtetësi, pasi nuk kam folur me Panuçin. Nëse Roma ka interes, do të thotë që kemi një trajner të mirë, që zgjon interesin edhe të klubeve të tilla, por edhe njohur nga afër Panuçin, mund t'ju them se është një aftësi shumë serioze që të mos nisë bisedimet me klubin, pa u konsultuar më parë me ne, duke qenë se është nën kontratë.

**Të ka shqetësuar marrëdhënia e Panuçit me mediën, apo edhe me një reagim ndaj tifozëve?**

Nuk më ka ardhur mirë dhe personalisht i kam bërë vërejtje. Në krahasim me trajnerët e tjerë të mëparshëm, Panuçi reklamoi më pak sesa ka në të vërtetë. Nuk kujdeset të bëjë promovim për veten, sesa për të bërë punën e tij, ndonëse është detyrë e tij që të vendosë një raport korrekt me median.

**Sa besim keni që Kombëtarja mund të përsërisë kualifikimin për në Europlanin e ardhshëm?**

Duhet të kemi parasysh që ky është një mision i vështirë, por jo i pamundur. Që të bëhet i mundur, duhet që shumë faktorë të bëhen bashkë dhe të bëjmë një edicion perfekt. Grupi është i komplikuar pasi në Europë nuk ka më skuadra me të cilat ti mund të marrësh 6 pikë të sigurta pa hyrë në fushë. Kemi në grup kampionët e botës, Turqinë, që mund të renditet edhe në vazhdim të tyre, pasi ka në përbërje

emra dhe futbollistë shumë të mirë. Pavarësisht rezultateve të fundit, Turqia mbetet një skuadër me lojtarë që luajnë në klube të mëdha të Europës. Islanda ka treguar se ka një skuadër shumë të mirë, me futbollistë që shumica luajnë në Premier League. Shqipëria duhet të luftojë me këta kundërshtarë, por nuk duhet të mendojë asnjëherë se ka fitore të sigurt me Andorrën dhe Moldavinë. Duhet të bëjë maksimumin me këto të dyja, për të mos gabuar dhe më pas do të luftojmë për t'ia dalë. Mund të kishim edhe një grup më të vështirë, ndaj besoj të lufta për t'ia dalë.

**Flasim pak për kampionatin shqiptar. Ky vit ka qenë një nga më pak të kontestuarit, pasi u duk se skuadrat morën atë që meritonin...**

Të gjithë kampionatet e fundit, në këndvështrimin tim dhe jo vetëm, kanë qenë të forta dhe të luftuara, me 10 skuadra që kanë pak diferencë mes tyre. Këto lloj diferencash po eliminojnë çdo ditë e më shumë, dhe kështu vijmë edhe rezultate të paparashikueshme. Edhe vitin e kaluar ishte një kampionat shumë i luftuar në të gjitha nivelet, përveç Lushnjës që u shkëput disi. Edhe gjysma e kampionatit aktual është i luftuar, me kualitet dhe me talente që përfaqësojnë skuadrat të ndryshme, ndaj është e vështirë të parashikosh.

**Në Kupat e Europës kemi kaluar vetëm dy ture...**

Skenderbeu na ka mësuar të avancojmë shumë në kupat evropiane, ndërsa besoj se ndikoi edhe fati, pasi Partizani dhe Kukësi u eliminuan për shkak të një shorti të komplikuar. Megjithatë mendoj se meritojmë pak më shumë se këto dy ture, ndryshe nga disa vite më parë kur ishte diçka e

rrallë kalimi i një turi të vetëm.

**Pjesa e parë e këtij sezoni, ka prodhuar një garë shumë të ashpër, ku kushdo mund të fitojë ndaj kujtdo...**

Nëse shohim rezultatet, kup-tojmë që kampionati është i paparashikueshëm. Janë zhdukur diferencat mes skuadrave, por edhe ato të faktorit fushë. Çdo gjë është e hapur, ndonëse Partizani e ka mbyllur me meritë në krye, duke u shpallur kampion dimri. Të 6 skuadrat e kreut, i kanë mundësitë për të qenë kampionë dhe do të provojnë deri në fund për këtë.

**Mendoni se është përmirësuar niveli i arbitrimin, apo nuk po merren më klubet me gjykimin?**

Unë mendoj se arbitrat kanë gabuar edhe në këtë fillim kampionati, një lloj si në të tjerët, por vetë klubet tashmë kanë krijuar më shumë besim dhe janë bindur se kemi të bëjmë me gabime njerëzore, që janë pjesë e lojës. Arbitri është një lojtar, që nëse i krijon kushte të mira dhe pak presion, do të luajë më mirë dhe do të bëjë më pak gabime. Kemi parë edhe në VAR- gabime në vendime, jo më në atë arbitrimin njerëzor, ku duhet të vendosësh menjëherë.

**Një nga gjërat që duhet ta evidentojmë si problematikë, janë shumë ndeshje pa tifozë. Ka një dorë të hekur ndaj çdo lloj sjelljeje?**

Edhe mua nuk më pëlqen ky lloj dënimi, por nuk është se kemi gjetur një masë tjetër alternative që të parandalojë sjelljet e gabuara. Këtë pasojë parashikon Kodi i Disiplinës, por unë mendoj se duhet rritur bashkëpunimi mes klubeve dhe organeve kompetente, që të identifikohen individët që shkaktojnë rrëmujë në stadium dhe të dënohen

ata personalisht, pa pasur nevojë për dënime kolektive. Kjo do të ishte gjëja më e mirë, por për momentin nuk kemi arritur ta bëjmë këtë gjë, ndonëse po punojmë për t'ia dalë dhe për të përmirësuar edhe rregulloren. Kemi nevojë për shumë tifozë në stadium, ndaj edhe mua nuk më tingëllon mirë kjo situatë.

**Prekim pak krijimin e Ligës Profesioniste. E konsideroni këtë si një hap të parë drejt asaj se çfarë realitet duhet të përfaqësojë kjo ligë?**

Liga është një formë organizimi që teorikisht duhet të jetë më e mirë për Kategorinë Superiore. Ne po tentojmë të bëjmë atë që është më e mirë, por duhet të shohim nëse do të prodhojë një garë më të mirë, më shumë të ardhura, më pak fenomene negative. Pra, duhet ta shohim në praktikë, sepse teorikisht synohet përmirësimi i të gjitha aspekteve.

**Mendoni se na duhen edhe klube profesioniste, për një ligë profesioniste?**

Është diskutuar shpesh kjo çështje, por unë mendoj se nuk mund të jetë kusht për krijimin e Ligës, funksionimi i klubeve. Mendoj se të dy bashkë, pra klubet dhe Liga mund të ndihmojnë njëra-tjetrën drejt përmirësimit të organizimit, duke shkëmbyer më shumë eksperiencën dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin. Tani bashkë mund të punojmë për të shtuar emrin e Kategorisë Superiore, për të afruar donatorë etj., gjë që do të ndihmonte të gjithë klubet.

**Mbeteni ende i mendimit, që struktura e Kategorisë së Parë është e duhura për kampionatin tonë?**

10 skuadra është numri optimal për realitetin tonë sot, duke parë numrin e futbollistëve që kemi, për gjendjen financiare, për të ardhurat që krijohen nga të drejtat televizive etj. Nuk është ideale, por optimale, sepse unë do të preferoja 20 skuadra, por ne nuk kemi mundësi të krijojmë 20 skuadra konkurruese.

**A kemi një datë për hapjen e "Arenës Kombëtare"?**

Në vitin 2019, sigurisht që ne do të zhvillojmë ndeshje në stadiumin kombëtar dhe besoj se do ta inaugurojmë në maj ose në qershor.

**A ka gjetur zgjidhje edhe problemi që ju kemi reklamuar në lidhje me rimbursimin nga ana e Ministrisë së Financave?**

Sipas nesh dhe ekspertëve më të mirë ndërkombëtarë

që kemi kontraktuar për këtë çështje, ne kemi plotësisht të drejtë në kërkesat tona dhe uroj që Ministria e Financave, me ndërhyrjen e kryeministrit, të ndryshojë dhe të na rimbursojë, pasi në të kundërt cenohet investimi ynë për ndërtimin e stadiumit dhe kërcënohet përfundimi në kohë i tij.

**A kishte lidhje vizita e Sekretarit Organizativ të UEFA-s, edhe me këtë lloj problematike?**

Në fakt, vizita e tij ishte për të parë projektet dhe fazën e zhvillimit të tyre, por edhe për të parë pengesat financiare që na kanë dalë. Pati edhe një takim me kryeministrin, ku u diskutuan edhe këto lloj vështirësish.

**Ka një klimë jo fort pozitive në situatën financiare të shumë klubeve. Ju si e keni parë këtë situatë?**


Gjendja financiare e klubeve të futbollit, ka ardhur në përmirësim, pasi deri para pak vitesh kishin të ardhura zero dhe tashmë kanë disa të ardhura të sigurta si ato nga drejta televizive, por edhe sponsorët që kanë në bluzë. Edhe të ardhurat nga merkatoja, apo shitja e futbollistëve, po vijnë në rritje. Ne duhet të insistojmë për të siguruar të ardhura nga mosha e edukimit të futbollistëve, pasi nuk e kemi shfrytëzuar këtë aspekt. Klubet nuk janë në situatën më të mirë të mundshme ekonomike, por ka përmirësim të dukshëm. Sa i përket taksimit, duhet që ne bashkë me klubet, të llojmë dhe propozojmë për të arritur ato synime që kemi, për të mos larguar investitorët në sport.

**Pas reformës territoriale, prisja një kujdes të shtuar nga bashkitë e mëdha, ndaj sportit, por po më rezultoi e njëjta qasje...**

Kultura e investimit, mirëmbajtjes dhe shtimit të ambienteve sportive, është thuajse zero në klubet dhe në institucionet vendore. Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për shembull, nuk i kushton shumë që të ndërtojë më shumë të pavarur, 50 fusha futbollit, të cilat kushtojnë maksimalisht 10 milionë euro. Kështu do të shtonte ushtrimin e futbollit amator dhe atij të fëmijëve. Pra, nuk është çështje ekonomike, por çështje prioriteti. Unë mendoj se ka ardhur dita që vërtetë të menjohet për investimet në sport. Nuk është luks, por domosdoshmëri dhe lehtë e investuara në sport, i kthehen bashkisë dhe qeverisë, në forma nga më të ndryshmet.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Hari spiuqe.
4. Janë toksike.
9. Gjysmë arrest.
10. Janë vende pa ne.
13. Johnny i Donnie Brasco.
15. Priten nga meridianë.
18. Me të nxjerrin një letër.
20. U verbua nga Askushi.
21. Një britmë në arenë.
22. Shkrimtari i Jaccuse.
24. Si moral.
25. Nota e diapazonit.
26. Me dies në një liturgji.
27. Një mund të jetë edhe veprimi.
28. Eshhtë e re pas Krishtit.
29. Inicialet e Bergman aktore.
30. Ai i trëndafilit është i Umberto Eco-s.
32. Fise pa fe.

33. Një provë zjarri.
  34. Eshhtë mjeshtri me... baketë.
  37. Digjen po nuk u zbuluan.
  39. Iglit te Lazio.
  41. Kush del... mbështet.
  42. Mund të jetë unik.
  46. Ngrihen për atentate.
  47. Janë fjetore në kazerma.
  48. Altini mestushor.
- VERTIKAL**
1. Fillojnë matanë.
  2. Një Hans artist dadaist.
  3. Eshhtë mjet rrethanor lundrimi.
  5. Eshhtë ënjtje.
  6. Lumi i Elizit.
  7. Fillojnë mpirjen.
  8. Eshhtë e gjithë Hëna.
  10. Eshhtë qetësues për neurozat.
  11. Taylor aktore.

12. Daniel i Robinson Crusoe.
14. Kështu janë skenat që mallëngjejnë.
16. Eshhtë pjesë në skenë.
17. Lëvizje Ekologjike Lokale.
19. Përshkohej nga Leti.
22. Eshhtë muzika më e... kollajtë.
23. Grazia Cucinotta aktore.
24. Veriu pa ekstreme.
27. Janë tre në tricikël.
30. Scola, regjisor italian.
31. Kuftozjnë një metër.
34. Mbahet me inat.
35. Mbyllin kurse.
36. Ka një shpejtësi fantastike.
38. Laik kur s'është ai.
40. Një liqen i kripur.
43. Një mund të jetë fetar.
44. Eshhtë lloj papagalli.
45. Në hyrje të sallës.
46. Priten në skaje.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

1. Janë lokale me kubiste.
9. Me të nxjerrin në tapë.
11. Polanski regjisor.
12. Qeni i famshëm i Odiseut.
15. Mbeten në fund.
16. Gabon në ekstreme.
18. Rreh në kufij.
19. Eshhtë vepër për një... vepër.
23. Janë udhëtime për në një vend të shenjtë.
25. Dinë shumë gjuhë.
26. Një mendim.
27. Famëkeqi Capone.
28. Kush i kthen... të braktis.
29. Kisha pa zë.
30. I fejuari i kukullës Barbie.
32. Ritet pa re.
33. Një brinjë në skuadër.
35. Emri i Zola.


37. Eshhtë moshë e të miturit.
40. Një dispozitiv kohe.
41. Janë strehë për barinj.
42. Fillojnë aksionin.
43. Eshhtë ai që nuk qesh.
45. Të parat në ambient.
46. Gjysmë teorie.
47. Një binar.
48. Djeg kur bie.

**VERTIKAL**


1. Barrymore aktore.
2. Tiriak që qe tenist.
3. Ekstreme në studim.
4. Eshhtë kleri me papën.
5. Ndezur në aparaturo.
6. Katalur në krye.
7. Janë racë e pastër.
8. Një treg pa re.
10. Duhet fituar me djersë.
13. Një dritë për sake.
14. Lëvizin pasi mendohen shumë.
16. Janë sfera për bingo.
17. Eshhtë më pak se nxehtësi.
19. Gibson aktor.
20. Tregonin shkëlqevë dikur.
21. Mund të jenë fetare të tilla.
22. Kush nuk ka... nuk i ecën.
23. Një sherr në shtyp.
24. Një lidhëz.
25. Mund të jenë cigareash.
29. Mund të bëjë zoom.
31. Ndërmarrje Industriale Mirditë.
33. Pak konkrete.
34. Eshhtë i mirë me shokë shumë.
36. Artikull për shumë francezë.
38. Kanto kur nuk... ka.
39. Muzika me jam session.
44. Mbyllin një sherr.
45. Të fundit në sirtar.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

7	3	4				6			
		1	2		4		7		
					3	5	1		
8	9			1			2	5	
4	1			5	8			9	
					9				6
	2			3	5	8			
1	8	7							
		3							

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

5	9	8	2	6	4	7	3	1	
4	6	1	3	5	7	2	8	9	
2	7	3	8	9	1	5	4	6	
1	2	5	4	7	6	3	9	8	
8	3	9	1	2	5	6	7	4	
6	4	7	9	3	8	1	5	2	
3	1	2	5	8	9	4	6	7	
7	8	4	6	1	3	9	2	5	
9	5	6	7	4	2	8	1	3	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Ai që tradhton besimin tim, nuk vlen as respektin tim !!!

- Thonë se të gjithë njerëzit janë si hëna, kanë një anë të cilën kurrë nuk ia tregojnë askujt !!!

- Gabimi më i madh në jetë është të lejosh disa njerëz të qëndrojnë në jetën tuaj më shumë se sa e meritojnë!!!

- Të dashurosh dikë që nuk të do, është sikur të presësh një anije në aeroport.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

9	1	2	4	16		17	17	18	50	T	6A	S	U	P	A	I	K	K	U	R	S	I		
11	3	2	5	4	18	6		5	18	3	2	A	P	E	R	A	T	U	R	A	H	K		
9	6	9		9	10		2	18		2	1	T	T	O	P	A	T	P	A	P	A	S		
8	1		11	1	3	1	3	2	5	2	3	K	E	M	A	L	T	A	K	A	I			
17		12	4	1	3	2	6	1	8	2	6	1	P	A	R	E	T	I	T	R	U	R	I	
7	4	10	3	2	6	12	3	1			14	R	P	I	A	M	E	L	I	A	S			
13	6	12	5	2	3	9	4	1		11	6	18	E	T	A	T	E	T	L	S	H			
14	6	2	4	9	1		4	10		1	12	P	O	N	Y	E	R	I	I	U	T			
18	11		4	7		4		7	4	13		3	I	L	T	Y	M	I	E	M	K	E		
2	6	7			3	1	10	6		6	2	2	T	I	R	A	N	E	T	R	I	M	A	T
6	15	2	3	9	3		4	1	6	12	4	6	E	N	T	I	T	A	N	I	K	E	E	
16	5	12	3	7	4	13	6		9	3	6	1	T	A	U	E	T	K	U	R	A	T		

- E kaluara është mësues i të tashmes dhe udhëzuesi i të ardhmes.
- Kuptimi i vërtetë i jetës është të mbjellësh një pemë, nën hijen e së cilës nuk prisni për t'u ulur.
- Jeta është një komedi për ata që mendojnë dhe një tragjedi për ata që ndjejnë.

- Duke fshirë të kaluarën ndoshta fshin të ardhmen.
- Jeta është një teatër ose më mirë një dramë, ku rolet i luajnë pathjet, të qeshurat dhe të qarat.
- Rruga drejt lumturisë nuk është e drejtë ... Ka shumë kthesa të quajtura "gabime".

*Thënie të mënçura*

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQIJE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

ARMAND LINDA  
VAJII EM VEK L  
ADENI LAKE OAZE  
TAK M ILIT ANTE E  
A P I R A M I D A L E  
R A F I N E R I T E E L  
F A N A T I K E T T H I  
D E N A R A E G E G  
E A J E H E R O N J  
M A R I A N A P T I N E D A  
E T E R E T I K E T A A  
K A T A R A K T I A T I M

**FJALËKRYQI (2)**

ADAMT R E F O R M A T  
R E K O R D M E N E L A U  
S R T P E K I N M  
E R O S K A N O T A Z H I  
N T I R P O L E M I K A T I  
E C P E R I M E T E R M  
K R I T I M N A A T E  
E I K M T I N G R I D  
M A T E R I A L I L I G U  
I N A T T R U M O A Z  
L E G J E N T U A  
E T E A L T A R E T I T

